



## STUDIME POSTDIPLOMIKE

Teza e magjistraturës

**" Reformat fiskale në sektorin e tatimeve - nevoja dhe arsyeshmëria për një sistem optimal tatimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut"**

**Kandidat:**

Shkëlqim Sadiki

**Mentor:**

Doc. Shpresa Alija

**Tetovë, 2022**

## **DEKLARATË NDERI**

Deklaroj se punimi me titull ***”Reformat fiskale në sektorin e tatimeve - nevoja dhe arsyeshmëria për një sistem optimal tatimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut”*** është origjinal dhe se është rezultat i hulumtimit dhe analizave personale. Çdo punim i autorëve tjerë është përmendur dhe cituar në formën e duhur në këtë punim magjistrature. Për çdo dyshim dhe element plagjiature përgjigjem personalisht para çdo organi dhe institucioni në cilëndo formë, morale, materiale dhe penale.

Shkëlqim Sadiki,

---

Tetovë, 03.05.2022

## ABSTRAKT

Sistemi tatimor paraqet njërën nga komponentet më të rëndësishme të politikës ekonomike dhe burim kryesor i gjenerimit të të ardhurave fiskale dhe rritjes së përgjithshme ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ndryshimet më të mëdha në sistemet tatimore të vendeve në tranzicion dhe vendeve të zhvilluara u bënë në vitet e tetëdhjeta dhe nëntëdhjeta të shekullit XX-të, e që njëherit njihen ndryshe edhe si reforma tatimore.

**Qëllimi i këtij studimi** konsiston në mbledhjen, llogaritjen dhe analizimin e të dhënave për një sistem tatimor më optimal në Republikën e Maqedonisë së Veriut - optimalitet ky, që në rastin e studimit tonë është përqëndruar kryesisht në tatimet direkte, respektivisht në tatimin mbi fitim dhe në tatimin e të ardhurave personale. Për më tepër, studimi ynë sjell funksionimin e sistemit tatimor aktual dhe një analizë krahasimore të politikës tatimore të Sllovenisë, në kontekst të normave tatimore dhe të ardhurave tatimore që gjenerohen nga tatimet direkte.

**Metodologjia e studimit** bazohet në punime shkencore, artikuj të ndryshëm, dokumente dhe raporte zyrtare, ligje dhe akte ligjore në lidhje me ndryshimet esenciale të sistemit tatimor të RMV-së dhe Sllovenisë. Ndërsa, për testimin e hipotezave përpos ekzaminimit të literaturës kemi përdorur edhe gjenerimin e skenarëve për një sistem më optimal tatimor, bazuar në aplikimin e progresivitetit tre shkallësh në tatimin personal në të ardhura, siç është edhe në rastin e Sllovenisë.

**Rezultatet e gjeneruara nga skenarët** konstatojnë se, sistemi tatimor në Maqedoninë e Veriut ka hapsirë për aplikim të progresivitetit në tatimin personal në të ardhura dhe rritje të normës së tatimit në fitim - reforma këto, që do të mundësojnë arritjen e një optimaliteti në sistemin tonë tatimor, rrjedhimisht rritjen e të ardhurave nga tatimet direkte, si dhe përmirësimin e pabarazisë në shpërndarjes së të ardhurave, respektivisht uljen e hendekut mes të pasurve dhe të varfërve.

**Fjalët kyçe:** *sistemi tatimor, reformat tatimore, tatimet direkte, pabarazia në shpërndarje*

## АПСТРАКТ

Даночниот систем е една од најважните компоненти на економската политика и главен извор на генерирање фискални приходи и севкупен економски раст во Република Северна Македонија. Најголемите промени во даночните системи на земјите во транзиција и развиените земји се направени во осумдесеттите и деведесеттите години на дваесеттиот век, кои се познати и како даночни реформи.

**Целта на оваа студија** е да се соберат, пресметаат и анализираат податоци за пооптимален даночен систем во Република Северна Македонија - оваа оптималност, која во случајот на нашата студија е главно фокусирана на директните даноци, односно на данокот на добивка и персоналниот доход. Понатаму, нашата студија - се одвива кон функционирањето на сегашниот даночен систем и компаративна анализа со даночната политика на Словенија, во контекст на даночните стапки и даночните приходи генерирани од директните даноци.

**Методологијата на студијата** се заснова на научни трудови, различни списанија, официјални документи и извештаи, закони и правни акти поврзани со суштинските промени на даночниот систем на РСМ и Словенија. Додека, за тестирање на хипотезите, покрај испитувањето на литературата, користевме и генерирање на сценарија за пооптимален даночен систем, базиран на примена на тристепен прогресивност во персоналниот данок на доход, како што е случајот во Словенија.

**Резултатите генерирани од сценаријата** покажуваат дека даночниот систем во Северна Македонија има простор за примена на прогресивност во персоналниот данок на доход и зголемување на стапката на данокот на добивка. Овие реформи ќе овозможат постигнување оптималност во нашиот даночен систем, следствено и зголемување на директните даночни приходи, како и подобрување на нееднаквоста во распределбата на доходот, односно намалување на јазот меѓу богатите и сиромашните.

**Клучни зборови:** *даночен систем, даночни реформи, директни даноци, нееднаквост во распределбата*

## ABSTRACT

The tax system is one of the most important components of economic policy and the main source of fiscal revenue generation and overall economic growth in the Republic of North Macedonia. The biggest changes in the tax systems of countries in transition and developed countries were made in the eighties and nineties of the twentieth century, which are also known as tax reforms.

**The purpose of this study is to collect**, calculate and analyze data for a more optimal tax system in the Republic of North Macedonia - this optimality, which in the case of our study is mainly focused on direct taxes, respectively on profit tax and personal income tax. Furthermore, our study brings the functioning of the current tax system and a comparative analysis of Slovenia's tax policy, in the context of tax rates and tax revenues generated by direct taxes.

**The study methodology** is based on scientific papers, various articles, official documents and reports, laws and legal acts related to the essential changes of the tax system of RNM and Slovenia. Whereas, for testing the hypotheses, in addition to examining the literature, we also used the generation of scenarios for a more optimal tax system, based on the application of three-stage progressivity in personal income tax, as is the case in Slovenia.

**The results generated by the scenarios** show that the tax system in North Macedonia has room for application of progressiveness in personal income tax and increase of the profit tax rate - these reforms, which will enable the achievement of an optimality in our tax system , consequently increasing direct tax revenues, as well as improving the inequality in income distribution, respectively reducing the gap between rich and poor.

**Keywords:** *tax system, tax reforms, direct taxes, distribution inequality*

## **PËRMBAJTJA**

<b>HYRJE DHE QËLLIMET E STUDIMIT</b>	<b>7</b>
1. Hyrje	7
2. Qëllimet e studimit	8
3. Hipotezat	9
4. Metodologjia e hulumtimit	9
5. Rëndësia e punimit	10
<b>KAPITULLI I: KONCEPTI, KARAKTERISTIKAT E TATIMEVE DHE REFORMAT TATIMORE</b>	<b>11</b>
1.1. Tatimet dhe llojet e tyre	11
1.1.1. Tatimet direkte	11
1.1.2. Tatimet indirekte	12
1.2. Reformat tatimore në vendet e zhvilluara	13
1.2.1. Gjermania	13
1.2.2. Belgjika	14
1.2.3. Anglia	14
1.3. Reformat tatimore në vendet në tranzicion	15
1.3.1 Reformat tatimore në Shqipëri	16
1.3.2 Reformat tatimore në Kosovë	16
1.3.3 Reformat tatimore në Mal të Zi	17
1.3.4. Reformat tatimore në Bullgari	17
1.4. Rëndësia e tatimeve dhe objektivat e sistemit tatimor	18
1.4.1. Zhvillimi ekonomik	18
1.4.2. Punësimi i plotë	18
1.4.3. Stabiliteti i çmimeve:	19
1.4.4. Kontrolli i luhatjeve ciklike	19
1.4.5. Reduktimi i importit dhe inkurajimi për prodhime vendore	19
1.4.6. Mësime nga reforma tatimore	19
<b>KAPITULLI II: SISTEMI TATIMOR DHE REFORMAT TATIMORE NË MAQEDONIN E VERIUT</b>	<b>21</b>
2.1. Reformat tatimore dhe sistemi aktual tatimor në RMV-ë	21
2.1.1. Sistemi aktual tatimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut	23
2.2. Politikat tatimore në Maqedoninë e Veriut në raport me direktivën e Bashkimit Evropian	27
2.2.1. Të ardhurat nga tatimet në raport me PBB-në, në vendet e BE-së, dhe Maqedonisë së Veriut	28

2.3. Treguesit statistikor të gjenerimit të të ardhurave publike nga tatimet direkte dhe indirekte në Republikën e Maqedonisë së Veriut	29
2.3.1. Të ardhurat nga tatimi i të ardhurave personale	30
2.3.2. Të ardhurat nga tatimi mbi fitim	32
2.3.3. Të ardhurat nga tatimi i vlerës së shtuar (TVSH)	33
2.4. Rekomandimet e Bankës Botërore për një sistem tatimor më optimal në Maqedoninë e Veriut	34
<b>KAPITULLI III : POLITIKAT TATIMORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NË KRAHASIM ME REPUBLIKËN E SLOVENISË</b>	<b>37</b>
3.1. Reformat tatimore dhe sistemi tatimor në Republikën e Sllovenisë	37
3.1.1. Sistemi aktual tatimor në Republikën e Sllovenisë	39
3.2. Tatimi mbi të ardhurat personale dhe tatimi në fitim në Republikën e Sllovenisë	45
3.2.1. Të ardhurat nga tatimi mbi fitim në Slloveni	45
3.2.2. Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale në Slloveni	46
3.3. Rekomandimet e OECD-së, për ndryshimin e normave tatimore në të ardhurat personale në Slloveni	47
3.4. Analizë krahasimore e gjenerimit të të ardhurave nga tatimet direkte në Republikën e Maqedonisë së Veriut në raport me Republikën e Sllovenisë	48
3.4.1. Analizë krahasimore e gjenerimit të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale në Republikën e Sllovenisë në raport me Republikën e Maqedonisë së Veriut.	48
3.4.2. Analizë krahasimore e gjenerimit të të ardhurave nga tatimi mbi fitim në Republikën e Sllovenisë në raport me Republikën e Maqedonisë së Veriut.	51
<b>KAPITULLI IV: ANALIZË EMPIRIKE RRETH NEVOJËS DHE ARSYESHMËRISË PËR NJË SISTEM OPTIMAL TATIMOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT</b>	<b>54</b>
4.1. Shpërndarja e të ardhurave në Maqedoninë e Veriut	54
4.2. Aplikimi i tatimit progresiv prej 18, 23, 25% dhe efektet në gjenerimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale në Maqedoninë e Veriut	57
4.1.1. Skenari 1	58
4.1.2. Skenari 2	59
4.1.3. Skenari 3	59
4.1.4. Skenari 4	60
4.2. Testimi i hipotezave	62
<b>KAPITULLI V: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME</b>	<b>66</b>
<b>Bibliografia:</b>	<b>69</b>

## LISTA E TABELAVE

*Tabela 1: Struktura aktuale e tatimeve në Maqedoninë e Veriut*

*Tabela 2: Normat e tatimeve në vendet e Bashkimit Evropian*

*Tabela 3: Normat e tatimeve në vendet e rajonit*

*Tabela 4: Të ardhurat nga tatimet në vendet e BE-së dhe Maqedoninë e Veriut, si përqindje e PBB-së*

*Tabela 5: Të ardhurat nga tatimet si përqindje e PBB-së, në RMV për periudhën 2006-2020*

*Tabela 6: Të ardhurat nga tatimi i të ardhurave personale në Maqedoninë e Veriut, si përqindje e PBB-së dhe si përqindje e të ardhurave totale nga tatimet, për periudhën 2006-2020*

*Tabela 7: Të ardhura tnga tatimi mbi fitim në Maqedoninë e Veriut, si përqindje e PBB-së, dhe si përqindje e të ardhurave totale nga tatimet, për periudhën 2006-2020*

*Tabela 8: Të ardhurat nga tatimi i vlerës së shtuar (TVSH) në Maqedoninë e Veriut, si përqindje e PBB-së dhe si përqindje e të ardhurave totale nga tatimet, për periudhën 2006-2020*

*Tabela 9: Normat progresive të tatimit personal varësisht nga shuma e të ardhurave personale (në Euro), në Slloveni*

*Tabela 10: Normat tatimore të klasave në Slloveni*

*Tabela 11: Të ardhurat nga tatimi në fitim në Slloveni, si përqindje e PBB-së, dhe si përqindje e totalit të tatimeve, për periudhën 2006-2020*

*Tabela 12: Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale në Slloveni, si përqindje e PBB-së, dhe si përqindje e totalit të tatimeve, për periudhën 2006-2020*

*Tabela 13: Shpërndarrja e të ardhurave në Maqedoninë e Veriut*

*Tabela 14: Rritja e normës tatimore nga 10%, në 18% për personat me të ardhura mbi 700.000,00 denarë në vit, në Maqedoninë e Veriut*

*Tabela 15: Rritja e normës tatimore nga 10%, në 23 % për personat me të ardhura mbi 900.000,00 denarë në vit, në Maqedoninë e Veriut*

*Tabela 16: Rritja e normës tatimore nga 10% në 25% përqind për personat me të ardhura mbi 900.000,00 denar në vit, në Maqedoninë e Veriut*

*Tabela 17: Rritja e normës tatimore nga 10% në 15% përqind për personat me të ardhura mbi 1.440.000,00 denar në vit, në Maqedoninë e Veriut*



## LISTA E GRAFIKONEVE

*Grafikoni 1: Të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi të ardhurat personale si përqindje e PBB-së, për Slloveninë dhe Maqedoninë e Veriut, për periudhën 2006-2020.*

*Grafikoni 2: Të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi të ardhurat personale si përqindje e totalit të të ardhurave të gjeneruara nga tatimet për Slloveninë dhe Maqedoninë e Veriut, për periudhën 2006-2020.*

*Grafikoni 3: Të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi fitim si përqindje e PBB-së, për Slloveninë dhe Maqedoninë e Veriut, për periudhën 2006-2020*

*Grafikoni 4: Të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi fitim si përqindje e totalit të të ardhurave të gjeneruara nga tatimet për Slloveninë dhe Maqedoninë e Veriut, për periudhën 2006-2020*

*Grafikoni 5: Pjesëmarrja e 1%-shit, më të pasur në të ardhurat e përgjithshme në vendet e zhvilluara dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut*

# HYRJE DHE QËLLIMET E STUDIMIT

## 1. Hyrje

Sistemi tatimor dhe politika tatimore përfaqësojnë disa nga shenjat thelbësore të sovranitetit kombëtar të një vendi. Ndryshimet më të mëdha dhe më të rëndësishme në sistemin tatimor të vendeve të zhvilluara, në zhvillim dhe atyre në tranzicion u bënë në vitet tetëdhjetë dhe nëntëdhjetë të shekullit të 20-të - ndryshime këto, që njihen si reforma tatimore.

Vendet anëtare të BE-së, kanë sovranitet në drejtimin e politikës fiskale dhe tatimore. Ata rregullojnë sistemet e tyre të tatimeve në mënyrë të pavarur, d.m.th. në kornizën e tyre kombëtare, bazuar në masat dhe direktivat për sinkronizimin e ndërsjellë të tatimeve. Maqedonia si një kandidate për anëtarësim të plotë në Bashkimin Evropian është në përpjekje të vazhdueshme për të harmonizuar legjislacionin e saj me rregulloret ligjore të BE-së.

Sistemi tatimor i Republikës së Maqedonisë është një ndërthurje racionale e llojeve të ndryshme të tatimeve për arritjen e qëllimeve të politikës tatimore. Llojet e ndryshme të tatimeve nuk përfaqësohen në mënyrë të barabartë në strukturën e sistemit tatimor. Për nga aspekti i drejtësisë së tatimit, tatimet direkte janë më të përshtatshme, e kur merret parasysh efikasiteti ekonomik, atëherë tatimet indirekte janë më të preferueshme. Pra, këto dy grupe tatimesh nuk përjashtojnë njëra-tjetrën, respektivisht janë të lidhura reciprokisht duke përbërë një tërësi që ne i referohemi si sistem tatimor.

## 2. Qëllimet e studimit

Qëllimi i këtij studimi është mbledhja, sintetizimi dhe analizimi i të dhënave për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit tatimor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

*Pavarësisht se titulli i temës i referohet “Reformave fiskale në sektorin e tatimeve - nevoja dhe arsyeshmëria për një sistem optimal tatimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, studimi ynë analizon optimalitetin vetëm në shtyllën e parë të sistemit tatimor, respektivisht tatimet direkte (tatimin personal dhe atë në fitim), me mundësi studimi në të ardhmen edhe arritjen e optimalitetit edhe në dy shtyllat tjera të sistemit tatimor - tatimet indirekte dhe tatimet lokale, e që njëherit mbetet edhe kufizim i këtij studimi dhe sfidë për studim të mëtejshëm (ciklin e tretë).*

**Qëllimi i parë**, i titulluar **koncepti dhe karakteristikat themelore të tatimeve**, përcakton dhe analizon konceptin, karakteristikat dhe objektivat e tatimeve, si dhe karakteristikat themelore të sistemeve tatimore (elementet e tatimeve janë përpunuar dhe shpjeguar në detaje dhe përkufizimi i subjektit tatimor). Tatimet janë detyrime monetare të detyrueshme dhe të pakthyeshme nga të cilat nuk kursehen as personat juridik dhe as personat fizik që fitojnë të ardhura të caktuara. Në ekonomitë moderne, tatimimi ka qëllime të shumëfishta, sikurse: rritjen e të ardhurave për të financuar shpenzimet publike, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, rritjen e përgjithshme ekonomike, uljen e papunësisë, rishpërndarjen e të ardhurave dhe qëllime të tjera. Çdo lloj tatimi rregullohet nga një rregullore ligjore e cila përfshin elementet e tatimit, interpretimin e tij të qartë, anulimin e parregullsive dhe efikasitetin e tyre.

**Qëllimi i dytë**, i titulluar **sistemi tatimor i Republikës së Maqedonisë së Veriut** analizon sistemin tatimor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përmes studimit të tatimeve direkte dhe indirekte. Vendi ynë, si një kandidat për anëtarësim të plotë në Bashkimin Evropian po bën përpjekje të mëdha dhe të rëndësishme në harmonizimin e legjislacionit të saj me rregulloret ligjore të BE-së.

**Qëllimi i tretë**, i titulluar **sistemi tatimor optimal në Maqedoninë e Veriut** analizon elasticitetin e tatimeve dhe hapsiren tatimore për ngritje/ulje të tatimeve, respektivisht arritjen në një sistem tatimor më optimal që do të kontribuoj në uljen e shkallës së pabarazisë dhe varfërisë në Maqedoni, rrjedhimisht uljen e hendekut mes të pasurve dhe të varfërve (Maqedonia e Veriut karakterizohet me një varfëri të lartë).

### 3. Hipotezat

#### Hipoteza kryesore :

1. Përfshirja më e gjërë e detyruesve tatimor (bazës tatimore) kontribuon në gjenerimin e të ardhurave publike më të larta, rrjedhimisht ul hendekun mes të pasurve dhe të varfërve.

#### Hipotezat ndihmëse :

1. Si rezultat i nevojave, arsyeshmërisë dhe elasticitetit, Republika e Maqedonisë së Veriut ka hapsirë për ngritje/ulje të tatimeve, respektivisht për një sistem optimal tatimor.
2. Ndryshimi i normës tatimore tek tatimet direkte, rrjedhimisht rritja e bazës tatimore do të ndikoj në rritjen e të ardhurave publike nga tatimet edhe në uljen e varfërisë.
3. Republika e Maqedonisë së Veriut ka hapsirë që ta rrit normën e tatimit në fitim për 3 % - normë kjo, e cila do t'i mundëson vendit të gjeneroj të ardhura publike më të larta, e njëherit të mbetet një destinacion konkurrues për investimet e huaja.

### 4. Metodologjia e hulumtimit

Në përpunimin e këtij punimi hulumtues - shkencor, duke parë lëndën dhe qëllimet e hulumtimit përdoren metoda dhe teknika të përgjithshme dhe të veçanta shkencore me ndihmën e të cilave arrihet deri në përfundime (konkluzat) dhe rekomandime. Metoda e analizës si pjesë e hulumtimit bazohet në dokumente dhe raporte zyrtare, punime shkencore, artikuj të ndryshëm, ligje dhe akte ligjore, në lidhje me ndryshimet esenciale të sistemit tatimor dhe krijimin e sistemit të ri të RM-së.

Prej metodave të përgjithshme shkencore përdoret metoda statistikore, ku në mënyrë kuantitative jepen tabela dhe grafikone, në lidhje me pjesëmarrjen e tatimeve direkte, respektivisht tatimit personal në të ardhura dhe tatimit mbi fitim, si pjesëmarrje e PBB-së, dhe si përqindje e totalit të të ardhurave tatimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në Republikën e Sllovenisë.

Po ashtu, përdoret metoda komparative (krahasuese), ku shqyrtohen ngjajshmëritë dhe dallimet e sistemit tatimor të RMV-së, me vendet e OECD-së, në veçanti me Slloveninë, në lidhje me gjenerimin e të ardhurave - si mjete financiare për financimin e shpenzimeve publike.

## 5. Rëndësia e punimit

Tatimet direkte në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjithmonë kanë qenë subjekt i reformave të vazhdueshme dhe përmirësimeve shtesë për të arritur qëllimet kryesore të politikës tatimore, respektivisht thjeshtësine dhe efikasitetin, veçanërisht në periudhën pasi vendi ynë u bë kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Parimi i efikasitetit zakonisht kërkon një strukturë tatimore me norma më të ulëta të tatimeve ligjore (barrë më të ulët efektive të tatimeve të kompanive) - norma këto, që nuk do të shtrembërojë vendimet për investime - duke i mbajtur atë në kornizen e normave tatimore të Ballkanit Perëndimor.

Së këndejmi, rëndësi e veçantë do të ketë ndryshimi i normave tatimore në tatimin mbi fitim dhe mbi të ardhurat personale, gjegjësisht arritja në një sistem tatimor më optimal. Duke u nisur nga nevojat dhe arsyeshmëritë (sistemi aktual në Maqedonia e Veriut gjeneron të ardhura të ulta prej tatimeve direkte), pabarazitë në shpërndarjen e të ardhurave, sistemi ynë aktual përgjatë viteve nuk ka sjellë ndonjë zhvillim në drejtim të uljes së hendekut mes të pasurve dhe të varfërve. Kjo e fundit, na bën me dije se, sistemi aktual tatimor i Republikës së Maqedonisë së Veriut duhet të zëvendësohet me një sistem më optimal tatimor, rrjedhimisht të sjell aplikimin e progresivitetit tek tatimet direkte deri në atë masë sa që të mos ndikoj negativisht në vendimet ekonomike, respektivisht në demotivimin e iniciativës për biznes, e me këtë të zvogëlon edhe hendekun mes të pasurve dhe të varfërve.

# KAPITULLI I: KONCEPTI, KARAKTERISTIKAT E TATIMEVE DHE REFORMAT TATIMORE

*"Njerëzit, me të vërtetë duhet të besojnë në sistemin e tyre tatimor. Ato, në njërin anë duhet të besojnë se ka një shpërndarje të barabartë të barrës tatimore, dhe nga ana tjetër, se egziston një investim i rëndësishëm i bazuar mbi arritjet e mundshme që vijnë nga pagesat e tyre tatimore"(Richard Neal).*

## 1.1. Tatimet dhe llojet e tyre

Tatimet janë të ardhura në para të shtetit që përcaktohen dhe imponohen me ligj dhe nuk janë të kthyeshme, e as që ka kompenzim të caktuar paraprakisht për to. Historikun e tatimeve të cilin më së miri e ka përshkruar K. Neumark, i cili thotë se: "Nga dhurimet formale paraprake vullnetare përmes dhënieve dhe bartjeve edhe më tutje mbi bazë vullnetare, por me prezencë dominuese të elementeve të detyrueshmërisë janë zhvilluar tatimet, si të ardhura juridike të detyrueshme"<sup>1</sup>.

Vendet mbarëkombëtare zbatojnë një sistem tatimor që ju shërben për shlyerjen e nevojave kombëtare publike të përbashkëta ose të dakorduara dhe për funksionet e qeverisë. Për më tepër, ky sistem ndërthet një mori të tatimeve sikurse, tatimet mbi: të ardhurat personale, fitim, vlerën e shtuar, pasuri, trashëgimi, dhurata, pronë, shitje, paga, detyrime, etj.

Për ofrimin e shërbimeve cilësore publike vendet e ndryshme përdorin sisteme tatimore të ndryshme, respektivisht lloje të ndryshme të tatimeve që klasifikohen kryesisht në dy grupe, edhe atë: tatime direkte dhe tatime indirekte (të elaboruara në vijim).

### 1.1.1. Tatimet direkte

Tatimi direkt është një lloj ngarkese e cila vendoset drejtpërdrejt mbi tatimpaguesin dhe i paguhet drejtpërdrejt qeverisë nga personat mbi të cilët është vendosur si tatim. Tatimet direkte klasifikohen në dy lloje të ndryshme, sikurse:

- tatimi mbi të ardhurat personale;
- tatimi mbi fitimi.

---

<sup>1</sup> Për më tepër rreth tatimeve shërbehuni me : A.Bexheti, "Financa Publike", fq.97, Tetovë. 2017.

**Termi tatim mbi të ardhurat** i referohet një lloji të tatimit që qeveritë vendosin mbi të ardhurat e krijuara nga bizneset dhe individët. Sipas ligjit për tatim mbi të ardhurat personale, tatimpaguesit duhet të paraqesin një deklaratë tatimore mbi të ardhurat çdo vit për të përcaktuar detyrimet e tyre tatimore<sup>2</sup>.

**Tatimi i korporatës** është një tatim mbi fitimet e një korporate. Tatimet paguhen mbi të ardhurat e tatueshme të një kompanie të cilat përfshijnë të ardhurat minus koston e mallrave të shitura, shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, shitjen dhe marketingun, kërkimin dhe zhvillimin, zhvlerësimin dhe kostot e tjera të funksionimit. Për më tej, normat e tatimeve të korporatave ndryshojnë shumë sipas vendeve, respektivisht disa vende konsiderohen si parajsë tatimore për shkak të normave të tyre të ulëta. Tatimet e korporatave mund të ulen me zbritje të ndryshme, subvencione qeveritare dhe hapsira tatimore.<sup>3</sup>

### 1.1.2. Tatimet indirekte

Një tatim indirekt është një tatim që vendoset mbi mallrat dhe shërbimet para se të arrijnë te klienti i cili në fund paguan tatim indirekt, si pjesë e çmimit të tregut të mallit ose shërbimit të blerë. Tatimet indirekte klasifikohen në:

- Tatim mbi vlerën e shtuar
- Akciza
- Dogana

**Tatimi mbi vlerën e shtuar** është tatim i përgjithshëm i cili llogaritet dhe paguhet në secilën fazë të konsumit të mallrave, tregtisë dhe shërbimeve, përveç rasteve të cilat nuk janë të parapara me ligj. Subjekt i tatimit është qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve në vend që realizohet me kompensim nga tatimpaguesi për veprimtarinë e tij ekonomike dhe importit të mallrave<sup>4</sup>.

**Akciza** është një tatim për mallra ose shërbime të veçanta të tilla si karburant, duhan dhe alkool. Tatimet e akcizës janë tatime kombëtare të vendosura brenda një infrastrukture qeveritare dhe jo tatime ndërkombëtare të vendosura përtej kufijve të vendit. Një akcizë federale zakonisht mblidhet nga shitjet e karburantit motorik, biletat ajrore, duhanit dhe nga mallra dhe shërbime të tjera<sup>5</sup>.

---

<sup>2</sup> Për më shumë rreth tatimeve mbi të ardhurat shërbehuni me :B.J.Jante, " *Income Tax* ", April, 2021.

<sup>3</sup> Për më shumë rreth tatimit mbi fitim shërbehuni me: K. Julia, " *Corporate Tax* ", February, 2021.  
<https://www.investopedia.com/terms/c/corporatetax.asp>

<sup>4</sup> Për më shumë rreth tatimit në vlerën e shtuar shërbehuni me: " *Eja te flasim për tatimet* ", Fondacioni Fridrih Ebert  
<http://library.fes.de/pdf-files/bueros/skopje/15604.pdf>

<sup>5</sup> Për më shumë rreth akcizës shërbehuni me: " *Publication 510, Excise Tax (Including Fuel Tax Credits and Refunds,* " Page 2.  
Accessed Jan. 19, 2020.

**Dogana (taksa e importit)**, është një taksë e mbledhur për importet dhe disa eksporte nga autoritetet doganore të një vendi. Vlera e një malli zakonisht do të diktojë detyrimin e importit. Në varësi të kontekstit, tatimi në importi mund të njihet edhe si detyrim doganor, taksë ose tarifë importi.

Pra, ashtu si tatimet direkte edhe tatimet indirekte janë burim kryesor për financimin e shpenzimeve publike, e me këtë edhe ofrimin e shërbimeve cilësore publike.

## 1.2. Reformat tatimore në vendet e zhvilluara

Siç e dimë, vendet e zhvilluara (Gjermania, Belgjika, Anglia, etj) dhe ato në tranzicion (Shqipëria, Bullgaria, Kosova, Mali i Zi, etj), kanë pësuar në reforma të vazhdueshme tatimore, me qëllim të arritjes së një sistemi optimal tatimor.

### 1.2.1. Gjermania

Gjermania përgjatë viteve pësoi disa reforma të rëndësishme tatimore sikurse në vijim:

- Ulja e normave të tatimit mbi të ardhurat nga 51.0%/22.9%, në vitin 2000, në 48.5%/19.9% në vitin 2001, 47.0%/17.0%, në vitin 2003, në 43.0%/15.0%, në vitin 2005. Përfshirë solidaritetin normat e hyrjes pritej të ulen nga 53.8%/22.9%, në vitin 2000, në 44.3%/15% në vitin 2005.
- Ulje e kontributeve të sigurimeve shoqërore në sistemin e pensioneve me 0.8 pikë përqindje.
- Ulja e normave tatimore të korporatave për fitimet e mbajtura/shpërndarra nga 40%/30%, në vitin 2000, në 25%, në vitin 2001. Tatimi efektiv i biznesit (duke përfshirë tatimin e tregtisë lokale dhe shtesën e solidaritetit), duhej të ulej nga rreth 52%, në vitin 2000, në rreth 39%, në vitin 2001.
- Eliminimi i tatimeve mbi fitimet kapitale nga shitjet e aksioneve nga korporatat që nga viti 2002, nëse dhe vetëm nëse këto aksione janë mbajtur për të paktën një vit. Kompanitë jo të inkorporuara (që paguanin tatim mbi të ardhurat personale), mund të kursenin ende për investime të mëvonshme.
- Rritja e taksave ekologjike<sup>6</sup>.

---

<sup>6</sup> Për më shumë rreth reformave në sistemin tatimor në Gjermani, shërbehuni me : " *The Reform of Taxation in EU Member States*", nga Centre d'études et d'Information Internationales (CEPII) Paris, page 88, May 2001.  
[https://www.europarl.europa.eu/workingpapers/econ/pdf/127\\_en.pdf](https://www.europarl.europa.eu/workingpapers/econ/pdf/127_en.pdf)



### 1.2.2. Belgjika

Përgjatë viteve Belgjia ka zbatuar disa ndërhyrje në sistemin e saj tatimor. Duke parë elasticitetin e saj për rritje/ulje të tatimeve ka realizuar disa reforma, edhe atë:

- Reforma e tatimit mbi të ardhurat për vitin 2001: inkorporimi i një kredie tatimore të rimbursueshme për individët me të ardhura modeste, rritja e uljes (zbritjes) së shpenzimeve nga 20%, në 25% për individët që i nënshtrohen normës më të ulët tatimore, si dhe rregullimi i grupeve tatimore për të ardhurat mesatare.
- Ulje e kontributeve të sigurimeve shoqërore.
- Ulja e TVSH-së për shërbimet intensive të punës në vitin 2000.
- Ulja e normës të tatimit të korporatave nga 40.17%, në 30% (15% për disa kategori kompanish, si SME-të teknologjike). Që nga viti 1998, pranueshmëria e kapitalit informal (si njohuritë, njohja e markës, baza e klientit), për amortizimin në llogaritjen e fitimit të tatueshëm (por jo për fitimin kontabël).<sup>7</sup>

### 1.2.3. Anglia

Anglia përgjatë viteve po ashtu, zbatoi disa reforma tatimore në sistemin e saj tatimor, sikurse në vijim:

- Ulja e normës bazë të tatimit mbi të ardhurat nga 23%, në 22%, në vitin 2000/01 (viti fiskal). Ndalimi i disa shtesave (lehtësimit i tatimit në hipotekë, shtesa për çiftin e martuar, përveç të moshuarve) dhe kreditimi i tatimeve për fëmijët u prezantua në 2001/02.
- Heqja e TVSH-së, për SME-të, me qarkullim deri në 54,000 £. Ulje e TVSH-së, për firmat me qarkullim ndërmjet £54,000 dhe £100,000.
- Ulja e normës së tatimit mbi korporatat nga 33% në 30%.
- Heqja e tatimit të mbajtur në burim për obligacionet ndërkombëtare, si dhe për pagesat e interesave dhe honorareve ndërmjet kompanive në Angli<sup>8</sup>.

---

<sup>7</sup> Për më shumë rreth reformave në sistemin tatimor në Belgji shërbehuni me : " The Reform of Taxation in EU Member States", nga Centre d'études et d'Information Internationales (CEPII) Paris, page 87, May 2001.

[https://www.europarl.europa.eu/workingpapers/econ/pdf/127\\_en.pdf](https://www.europarl.europa.eu/workingpapers/econ/pdf/127_en.pdf)

<sup>8</sup> Për më shumë rreth reformave në sistemin tatimor në Anglia shërbehuni me: " The Reform of Taxation in EU Member States", nga Centre d'études et d'Information Internationales (CEPII) Paris, p. 90, May, 2001.

[https://www.europarl.europa.eu/workingpapers/econ/pdf/127\\_en.pdf](https://www.europarl.europa.eu/workingpapers/econ/pdf/127_en.pdf)

Pra, sitemet tatimore të vendeve të zhvilluara krahasuar me vendet me zhvillim të mëvonshëm (në tranzicion) janë më të përsosura dhe me mundësi shumë të uët për evazion fiskal. Përpos arritjes më të lartë të mirëqenies sociale, implementimi i reformave tatimore është shumë më i lehtë dhe i pranueshëm në vendet e zhvilluara kundrejt atyre në zhvillim (në vendet në tranzicion shumë më vështirë realizohen reformat tatimore).

### 1.3. Reformat tatimore në vendet në tranzicion

Reforma tatimore konsiderohet gjithnjë e më shumë si një element i rëndësishëm, i programeve të rregullimit shoqëror të mbështetura nga Banka Botrore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Mos balancimet e bilancit të pagesave shpesh e kanë origjinën në politikat fiskale të papërshtatshme, ndonëse ka një njohje në rritje se mosbalancimet fiskale nuk mund të adresohen thjeshtë në kufizimin e shpenzimeve publike. Për më tepër, sitemet tatimore të shumë vendeve në tranzicion apo zhvillim të mëvonshëm janë shpesh shtrembëruese, e gjithashtu kontribuojnë ndjeshëm në problemet e shpërndarjes së të ardhurave publike.

Një projekt kërkimor i Bankës Botërore i nisur në fillim të vitit 1988, shqyrtoi përvojën me reformën tatimore në dhjetë vende në zhvillim, me synimin për të nxjerrë mësim (përvoja të reja), për vendet e tjera që po mendonin reforma të ngjashme tatimore. Vendet e përfshira në studim ishin Bolivia, Kolumbia, Xhamajka, Indonezia, Malavi, Meksika, Maroku, Republika e Koresë, Turqia dhe Zimbabve. Rezultatet e projektit dhe hulumtimet e fundit të Bankës mbi një numër çështjesh të veçanta të politikës tatimore, u diskutuan në një konferencë të mbajtur në muajin mars, të vitit 1990.

Për më tej, konferenca në fjalë u përqëndrua (rishikoi) në tatimin e investimeve të huaja, burimet dhe institucionet financiare, hartimin e tatimeve indirekte, incidencën tatimore, modelet e politikave tatimore dhe në rritje ekonomike. Pra, rishikimi i përvojave të reformës tatimore tregoi se, strukturat tatimore në shumicën e vendeve në zhvillim ishin<sup>9</sup>:

- **komplekse**, respektivisht vështirë për tu administruar dhe respektuar;
- **joelastike**, nuk reagon ndaj rritjes dhe strukturës në ndryshim të aktivitetit ekonomik;
- **joefikase**, përfshirë shtrembërime serioze ekonomike duke rritur relativisht pak të ardhura;
- **të pabarabartë**, nuk trajtonin individët dhe bizneset në rrethana të ngjashme, në mënyra të ndryshme;
- **të padrejta**, administrata tatimore dhe zbatimi ishin selektiv dhe favorizonin ata me aftësinë për të mposhtur sistemin tatimor.

---

<sup>9</sup> Për më shumë rreth reformave në vendet në zhvillim shërbehuni me: J. Khalilzadeh - Shirazi, A. Shah, „Tax Reform in Developing“, June, 1991 <https://elibrary.worldbank.org/doi/abs/10.1596/0-8213-1990-6>

Vetëm shumë pak vende në zhvillim kanë arritur të krijojnë sisteme tatimore në mënyrë të tillë që të arrijnë një nivel të përshtatshëm të ardhurash dhe të mbajnë shpërndarjet e gabuara, të krijuara nga tatimet brenda kufijve të ngushtë (një shembull i tillë është shteti i qytetit të Singaporit). Në shumicën e vendeve të tjera, as nuk ka qenë e mundur të sigurohet financimi i shpenzimeve publike, istemet tatimore nuk kanë funksionuar në përputhje me objektivat e politikave ekonomike, të tilla si rritja dhe luftimi i varfërisë<sup>10</sup>.

Për më tepër, reforma më e nevojshme tatimore vjen nga ana e të ardhurave. Vlersimet e bëra nga Banka Botrore për periudhën 1975-1985, treguan se, në vendet industriale raporti mesatar i tatimit, një proporcion i prodhimit të brendshëm bruto ishte midis 29% dhe 32%, ndërsa diapazoni përkatës për vendet në zhvillim në kategorinë me të ardhura mesatare ishte nga 17% në 22%, kurse në vendet më të varfëra varionte nga 13% në 16%. Përqindjet janë relativisht të larta në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut për shkak të honorareve dhe tatimeve të tjera të ngritura nga eksportet e naftës, të cilat gjithashtu klasifikohen si tatim. Në Afrikë, Amerikën Latine, Ishujt Karaibe dhe në Azinë Lindore, vlerat përkatëse qëndrojnë midis 14% dhe 18%, dhe në rangun 10% -14% në Azinë Juglindore<sup>11</sup>.

### 1.3.1 Reformat tatimore në Shqipëri

Përgjatë viteve Shqipëria ka zbatuar po ashtu reforma tatimore në sistemin e saj tatimor. Duke marr parasysh elasticitetin e saj tatimor për rritje/ulje të tatimeve, ajo ka realizuar disa reforma tatimore, edhe atë:

- Tatimit mbi të ardhurat personale (5% - 30%), nga 1 korrik i vitit 2007 u zëvendësua me një normë të sheshtë prej 10%, kurse aktualisht është 13%-23%.
- Tatimi mbi fitim paraprakisht ishte 30%, pastaj 20%, ndërsa nga 1 janari, i vitit 2008 norma u zvogëluar në 10%. Aktualisht tatimi mbi fitim është progresiv, me një normë prej 0-15%.
- TVSH-ja, u vendos në vitin 1996 me norma 20% dhe 0% duke vazhduar edhe sot e kësaj dite<sup>12</sup>.

---

<sup>10</sup> Për më shumë rreth reformave në vendet në zhvillim shërbehuni me: Cf. S. Acharya, "The Indian Economy. Recent Development and Future Prospects", Boulder, London 1988.

<sup>11</sup> Për më shumë rreth reformave në vendet në zhvillim shërbehuni me: 4 Cf. World Bank: World Development Report 1988, Washington, D.C., 1988.

<sup>12</sup> Për më shumë rreth reformave tatimore në Shqipëri shërbehuni me: Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, "Historiku I Tatimeve", <https://www.financa.gov.al/historiku-i-tatimeve>

### 1.3.2 Reformat tatimore në Kosovë

Qeveria e Kosovës, nga 1 Janar i vitit 2009, ka filluar së zbatuari ligjin e ri me zbritje në normat tatimore, sikurse<sup>13</sup>:

- Tatimet në dividendë, interes, dhe disa lloje tjera u zvogluan nga 20% në 10%.
- Tatimi në të ardhura personale ka ndryshuar në normën tatimore, respektivisht prej 0%, 5%, 10% dhe 20%, në 0%, 4%, 8% dhe 10%, sa janë edhe aktualisht (do të thotë se norma më e lartë e këtij tatimi do të jetë 10%).
- Tatimi mbi fitim ndryshoi në normë tatimore nga 20%, në 10%.
- TVSH-ja, u rrit nga 15% në 16%, kurse aktualisht është 18-8%.

### 1.3.3 Reformat tatimore ne Mal të Zi

Mali i Zi përgjatë viteve realizoi disa reforma tatimore në sistemin e tatimor, edhe atë:

- Tatimi në të ardhura personale kishte normën fikse prej 14%, u zëvendësua me tre norma 10%, 15% dhe 20%.
- Tatimi mbi fitim paraprakisht kishte norma 20% - 30%, në vitin 2003 u zëvendësua me 14%, kurse aktualisht është 10%.
- Heqja e tatimit mbi vlerën e shtuar për shërbimet publike dhe disa produkte ushqimore<sup>14</sup>.

### 1.3.4. Reformat tatimore në Bullgari

Bullgaria, po ashtu përgjatë viteve pësoi në disa reforma tatimore në sistemin tatimor, sikurse në vijim:

- Tatimi në të ardhura personale në vitin 1992 nga gjashtë norma 20%, 24%, 28%, 32%, 36% dhe 40% u zëvendësuan me katër norma tatimore. Aktualisht, tatimi personal në të ardhura është 10%.
- Tek tatimi në fitim në vitin 2000 norma tatimor u zvoglua nga 25% në 20% për bizneset e vogla, kurse pas një viti e njëjta norma u rit për 3.5%. Nga 1 janari i vitit 2007, norma tatimor e tatimit në fitim është 10%.

---

<sup>13</sup> Për më shumë rreth reformave tatimore në Kosovë shërbehuni me : B. Peci, "Reformat tatimore në shtetet ballkanike - rasti i Kosovës", fq. 55, 2009.

<sup>14</sup> Për më shumë rreth reformave tatimore në Mal të Zi shërbehuni me: Taxation in Montenegro, "Tax System".  
<https://montenegrotaxation.com>

- Tatimi në vlerën e shtuar në vitin 1999 u ulë nga 22% në 20%, ku edhe aktualisht është e tillë<sup>15</sup>.

Pra, arsyeja kryesore e ndërmarrjes së reformave tatimore në vendet në tranzicion ka qenë kryesisht gjenerimi i të ardhurave publike për financimin e shpenzimeve publike, e me këtë edhe ofrimin e një oferte sa më të mirë publike për qytetarët e RMV-së.

#### **1.4. Rëndësia e tatimeve dhe objektivat e sistemit tatimor**

Tatimet si të ardhura të shtetit janë të imponueshme dhe të pakthyeshme, përfshijnë mbledhjen e detyruar të fondeve nga individë, kompani dhe organizata, pra janë shtylla kryesore në gjetjen e fondeve për financimin e shpenzimeve publike<sup>16</sup>.

Qëllimi kryesorë i tatimeve është të gjenerojë sa më shumë të ardhura për financimin e shpenzimeve publike. Tatimet duhet të vendosen në mënyrë të barabartë, respektivisht sipas aftësisë paguese. Niveli i të ardhurave dhe aktiveve të disponueshme për një individ janë masa më e mirë e aftësisë paguese, gjegjësisht në baza të barazisë ku normat më të larta të tatimeve të zbatohen për njerëzit me të ardhura më të larta. Mbi të gjitha, tatimet duhet të jenë:

- të barabarta midis brezave të ndryshëm që do të thotë se, njerëzit me të njëjtën aftësi paguese duhet të paguajnë të njëjtën sasi tatimi, pavarësisht nga mosha e tyre (sistemi duhet të jetë neutral ndaj moshës);
- rritëse në atë mënyrë që të minimizojnë kostot ekonomike përmes shtrembërimeve ose paragjykimeve të krijuara nga tatimet, si dhe në proporcion të njëjtë me rritjen e të ardhurave, dhe;
- sa më të thjeshta, transparente dhe të parashikueshme për individët dhe subjektet private dhe publike.

Së fundmi, sistemi tatimor ndikon në vëllimin e përgjithshëm të prodhimit, konsumit, investimit, zgjedhjes së lokacionit dhe teknikave industriale, bilancit e pagesave, shpërndarjes e të ardhurave, etj. Për më tepër, politika tatimore ndikon në arritjen e disa objektivave esenciale ekonomike, respektivisht në zhvillimin ekonomik, punësimin e plotë, stabilitetin e çmimeve, kontrollin e luhatjeve ciklike, reduktimin e importit dhe inkurajimin e prodhimit vendor, etj.

---

<sup>15</sup> Për më shumë rreth reformave tatimore në Bullgari shërbehuni me: Ministry of Finance, "Tax System".

<https://www.minfin.bg/en/6>

<sup>16</sup> Për më shumë rreth tatimeve shërbehuni me: IBFD Publikations, "Tax policy in OECD Countries", Amsterdam, str.52, 1993.

#### **1.4.1. Zhvillimi ekonomik**

Një nga objektivat kryesore të tatimit është zhvillimi ekonomik. Ky i fundit, kushtëzohet kryesisht nga rritja e formimit të kapitalit duke rritur normën ekzistuese të tatimeve, ose duke vendosur tatime të reja. Po ashtu, si një nga elementët e rëndësishëm të zhvillimit ekonomik është rritja e raportit të kursimeve dhe të ardhurave, e cila mund të rritet në mënyrë efektive përmes politikës tatimore.

#### **1.4.2. Punësimi i plotë**

Meqenëse niveli i punësimit varet nga kërkesa efektive, një vend që dëshiron të arrijë qëllimin e punësimit të plotë duhet të ulë normën e tatimeve. Rrjedhimisht, të ardhurat e disponueshme do të rriten, e kështu kërkesa për mallra dhe shërbime do të rritet. Rritja e kërkesës do të stimulojë investimet duke çuar në rritjen e të ardhurave dhe punësimit përmes mekanizmit të multiplikatorit (shumëzuesit).

#### **1.4.3. Stabiliteti i çmimeve:**

Tatimi mund të përdoret për të siguruar stabilitetin e çmimeve - një objektiv afatshkurtër i tatimit. Tatimi konsiderohet si një mjet efektiv për të kontrolluar inflacionin. Duke rritur normën e tatimeve direkte, shpenzimet private mund të kontrollohen, ku me ç'rast presioni në tregun e mallrave ulet. Mirëpo, tatimet indirekte të vendosura mbi mallrat nxisin tendencat inflacioniste. Çmimet e larta të mallrave nga njëra anë dekurajojnë konsumin, kurse nga ana tjetër nxisin kursimin. Andaj, efekti i kundërt do të ndodhë kur tatimet të ulen gjatë deflacionit.

#### **1.4.4. Kontrolli i luhatjeve ciklike**

Kontrolli i luhatjeve ciklike (periudha të lulëzimit dhe depresionit), konsiderohet të jetë një objektiv tjetër i tatimit. Gjatë depresionit tatimet ulen, ndërsa gjatë lulëzimit tatimet rriten në atë mënyrë që luhatjet ciklike të zbuten.

#### **1.4.5. Reduktimi i importit dhe inkurajimi për prodhime vendore**

Tatimet si detyrime doganore përdoren gjithashtu për të kontrolluar importet e mallrave të caktuara, me qëllim të uljes së intensitetit të vështirësive në bilancin e pagesave dhe inkurajimit të prodhimit vendor, rrjedhimisht uljen e importit të mallrave nga jashtë.

Pra, me ndihmën e tatimeve dhe politikës tatimore, sot gjithnjë e më shpesh bëhet neutralizimi i rritjes së fuqisë blerëse në treg dhe rritjes së çmimeve. Po ashtu, me ndihmën e politikës tatimore bëhet edhe rritja e emetimit të parave dhe kredive, gjë që ndikon në stabilizimin e cikleve ekonomike të shtetit - stabilizim ky, që njëherit është edhe objektiv i politikës moderne fiskale.

#### 1.4.6. Mësime nga reforma tatimore

Disa nga mësimet që mund të nxirren nga reformat tatimore janë sikurse në vijim:

- Zgjerimi i bazës tatimore dhe ulja ose ngritja e normave tatimore varësisht nga hapsira tatimore, duhet të jetë qëllimi kryesor i çdo nisme të reformës tatimore në vendet në zhvillim.
- Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), duhet të përbëjë një element të rëndësishëm të një agjende për reformën e tatimit të shitjes në vendet në zhvillim.
- Përmirësimi i administratës tatimore është një parakusht për suksesin e reformës tatimore.
- Përdorimi i sistemit tatimor për objektivat e të ardhurave (p.sh., preferencat tatimore për investime të veçanta), duhet të kufizohen.
- Reforma tatimore duhet të marrë parasysh kushtet fillestare brenda dhe jashtë vendit.

Pra, për gjatë viteve duke ndjekur reformat e realizuara të vendeve në tranzicion (vende me vullnet politik), mund të themi se impenjimi dhe zbatimi i reformave tatimore brenda vendit synoi përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe mirëqenien shoqërore, rritjen e standardit jetësor, menjanimin e evazionit fiskal, etj.

## KAPITULLI II: SISTEMI TATIMOR DHE REFOTMAT TATIMORE NË MAQEDONIN E VERIUT

*Të harxhoj, më zëmëron gjithmonë.  
RHETT BUTLER në filmin "Gone with the Wind".*

### 2.1. Reformat tatimore dhe sistemi aktual tatimor në RMV-ë

Siç e dimë, vendet e zhvilluara ashtu edhe ato në tranzicion kanë pësuar në reforma tatimore. Reformat tatimore që u bënë në vendet e zhvilluara ishin pasoj e shkallës së lartë të evazionit fiskal, rritjes së shpenzimeve publike, defiçitit buxhetor, globalizimit dhe levizjes së kapitalit, etj. Ndërsa, objektivat kryesore të reformave tatimore para se gjithash përfshinin: thjeshtësimin e sistemit tatimor dhe rritjen e të ardhurave tatimore, nxitjen e investimeve të huaja direkte dhe zhvillimin ekonomik të vendit, uljen e ekonomisë informale dhe papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës, reduktimin e barrës tatimore dhe kostove administrative gjatë menaxhimit të të ardhurave publike, etj.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut sistemi tatimor i mëparshëm i krijuar në bashkësinë federale ka ekzistuar deri në vitin 1993. Pas pavarësisë së Maqedonisë, vendosmëria për të ndërtuar një ekonomi me parime tregu kërkoi reforma të mëdha në sistemin tatimor - reforma këto, që do të krijonin një sistem të tillë tatimor që do të ishte më efikas, racional dhe në përputhje me sistemet tatimore të vendeve me ekonomi tregu, e në veçanti me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Në bazë të një përcaktimi të tillë, në fillim të vitit 1992 u ndërtua "Koncepti për sistem të ri tatimor të Republikës së Maqedonisë"<sup>17</sup>.

Koncepti për një sistem të ri tatimorë propozoi një strukturë tatimore më efikase dhe rregullimin e llojeve të tatimeve duke i ndjekur sistemet tatimore ekzistuese të vendeve të zhvilluara.

Koncepti i një sistemi të ri tatimor propozoi zgjidhje në lidhje me strukturën tatimore dhe rregullimin e llojeve kryesore të tatimeve, të bazuara në modelet e sistemeve tatimore të vendeve të zhvilluara evropiane. Propozimet e ofruara mbuluan edhe politikën fiskale në Maqedoni dhe mundësitë objektive për zbatimin e suksesshëm të sistemit të ri tatimor.

---

<sup>17</sup> Për më shumë rreth reformave në Maqedoni shërbehuni me : Zh. Atanasovski, :*"Financa publike"*, Fakulteti Ekonomik, fq. 537, Shkup.



Për më tepër, koncepti për sistemin e ri tatimor mori parasysh njohuritë më të fundit teorike dhe empirike në lidhje me drejtimet e zhvillimit të sistemeve moderne tatimore, të cilat në thelb sugjeronin:<sup>18</sup>

- të hiqen nga sistemi tatimor elementet që sjellnin deformime në mekanizmin e çmimeve dhe në shpërndarjen e burimeve;
- zgjerimin e detyrimit tatimor dhe bazës tatimore në të gjitha llojet e tatimeve, si dhe arritjen e neutralitetit alokativ të sistemit tatimor;
- realizimin efikas të funksionit primar fiskal, në kushte të një niveli të përgjithshëm ekonomikisht të përballueshëm të barrës fiskale;
- realizimin me sukses të rolit të sistemit tatimor në politikën ekonomike në lidhje me korigjimin e lëvizjeve konjunkturale dhe inflacionin, si dhe nxitjen e synimeve strukturore dhe zhvillimore në ekonomi.

Angazhimi për të ndërtuar një sistem modern ekonomik që do t'i përgjigjet performancës efektive të funksioneve fiskale dhe jofiskale, impenjoi sendërtimin e një sistemi tatimor modern, i cili do të përfshinte format më të rëndësishme tatimore që janë shtylla kryesore e sistemeve moderne tatimore.

Në këtë kuptim, me futjen e sistemit të ri tatimor nga fillimi i vitit 1994, u bënë ndryshime thelbësore në krahasim me gjendjen e mëparshme në fushën tatimore. Ndryshimet përbëheshin sikurse më poshtë:

1. Sistemi tatimor celular u zëvendësua nga shtatë lloje të tatimeve në vetëm dy lloje edhe atë:
  - Tatimit mbi të ardhurat personale, dhe
  - Tatimit mbi fitim
2. Tatimi mbi konsum, tatimi mbi mallra dhe shërbime u mbajtë deri në vitin 2000, pastaj u zëvendësua me tatimin mbi vlerën e shtuar. Qarkullimi i pijeve alkoolike, derivateve të naftës dhe produkteve të duhanit tatóhet me akciza, të cilat janë të përshtatura me standardet evropiane.

---

<sup>18</sup> Po aty.

3. Në rastin e tatimit mbi pronën mbetën tre format tatimore edhe atë :
  - tatimi mbi pronën,
  - tatimi mbi shitjen e pasurive të paluajtshme, dhe
  - tatimi mbi trashëgiminë dhe dhuratën
4. Mbledhja e detyrimeve doganore, tarifave, faturave dhe tarifave komunale mbeti në sistemin e të ardhurave publike dhe u krijuan kushte ligjore për përdorimin e borxhit publik në financimin publik.
5. Sistemi i kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Pra, reformat tatimore në vitin 1994, u realizuan me qëllim të thjeshtësimit të sistemit, rritjes së efikasiteti dhe plotësimit të kërkesave të Bashkimit Evropian për një sistemin tatimor më optimal - optimalitet ky, që është edhe parakusht për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

### **2.1.1. Sistemi aktual tatimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

Sistemi tatimor nënkupton shumën e të gjitha tatimeve të vendosura në një vend bazuar në sovranitetin e tij fiskal. Një sistem tatimor nuk mund të krijohet thjesht sipas një plani, si rezultat i parimeve shkencore të paracaktuara, por krijohet në bazë të një kompromisi në mes forcave të ndryshme politike, nën ndikimin e zhvillimit historik dhe social të vendit, si dhe nga presioni i shtetit në mënyrë që të gjinden burime të reja për financimin e shpenzimeve publike, madje edhe nën ndikimin e faktorëve të jashtëm<sup>19</sup>.

Sipas interpretimit modern, sistemi tatimor përfshin të gjitha kontributet në paga dhe mëditje, të cilat inkorporohen për financimin e formave të detyrueshme të sigurimeve shoqërore.

Një sistem tatimor i dizajnuar jo mirë, ku rregullat dhe zbatimi i tyre janë jotransparente, tepër komplekse ose të paparashikueshme, mund të dekurajojë investimet duke shtuar kostot e projektit dhe pasigurinë. Sistemet që lënë lirinë e tepëruar administrative në duart e zyrtarëve tatimor priren të ftojnë korrupsionin dhe të minojnë objektivat e qeverisjes së mirë themelore për sigurimin e një mjedisi tërheqës investimi. Andaj, politikëbërësit inkurajohen të sigurojnë që sistemi i tyre tatimor të imponojë një barrë tatimore të pranueshme që mund të përcaktohet

---

<sup>19</sup> Për më shumë rreth sistemit tatimor shërbehuni me: P. Dejan, "Nauka o porezima i poresko pravo" Savremena administracija, Beograd, 1997.

me saktësi, e që mban nën kontroll pajtueshmërinë tatimore dhe kostot e administratës tatimore.

Për më tepër, qeveritë mundohen që të kenë një sistem tatimor sa më optimal, një barë tatimore të pranueshme dhe të arsyeshme që mund të përcaktohet me saktësi dhe që mban nën kontroll pajtueshmërinë tatimore dhe kostot e administratës tatimore.

Çështjet më të rëndësishme për të gjykuar efektivitetin e sistemit tatimor kanë të bëjnë me<sup>20</sup>:

- konsistencën e barrës tatimore të një vendi, me objektivat e tij më të gjera të zhvillimit;
- vlerësimin e barrës tatimore aktuale mbi fitimet e brendshme;
- krahasimin e barrës tatimore aktuale me objektivin;
- të kuptuarit e efekteve të mundshme tatimore në investime;
- vlerësimin e shtrembërimeve tatimore ndaj investimeve;
- përcaktimin e të ardhurave të tatueshme;
- llogaritjen e efekteve të paqëllimshme të stimulimit tatimor;
- raportimin e shpenzimeve tatimore;
- bashkëpunimin ndërkombëtar tatimor.

Aktualisht sistemi tatimore në Republikën Maqedonisë së Veriut përbëhet nga këto lloje të tatimeve:

#### 1. Tatimet në të ardhura

- Tatimi personal në të ardhura
- Tatimi në fitim

#### 2. Tatimet në konsum

- Tatimi i vlerës së shtuar (TVSH)
- Akcizat
- Doganat ( Tatimet ndërkombëtare )

#### 3. Tatimet në pasuri

- Tatimi në pasuri
- Tatimi në trashëgimi dhe dhurata
- Tatimi në qarkullim të pronave të paluajtshme dhe të drejtave

---

<sup>20</sup> Për më shumë rreth efektivitetit të sistemit tatimor shërbehuni me: OECD, "Policy framework for investment users toolkit", kapitulli 5, fq. 2.

#### 4. Kontributet për sigurimet shoqërore

- Kontributet nga rrogat dhe të ardhurat tjera të siguruesve.

### 1. Tatimet direkte

Sipas rregullores aktuale sistemi tatimor i Maqedonisë për tatimet direkte (tatimi mbi të ardhurat për një tatimpagues - person fizik dhe tatimi mbi fitimin për një tatimpagues - person juridik), karakterizohet me "tatim të sheshtë", si në tatimin mbi të ardhurat personale ashtu edhe në tatimin në fitim. Pra, në të dy rastet norma tatimore është 10%.

- Tatimi mbi të ardhurat personale paguhet mbi totalin e të ardhurave të fituara nga individë nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit gjatë një viti kalendarik. Të ardhurat që i nënshtrohen tatimit përbëhen nga të ardhurat personale, veprimtaria e pavarur, nga të ardhurat pronësore dhe të drejtat pronësore, honoraret dhe të drejtat e pronësisë industriale, të ardhurat nga kapitali, fitimet kapitale, fitimet nga lojërat e fatit dhe të ardhura të tjera<sup>21</sup>. Të ardhurat e sipërpërmendura i nënshtrohen tatimit, pavarësisht nëse realizohen në para, letra me vlerë, në natyrë apo në ndonjë lloj tjetër. Tatimpagues në të ardhura personale është çdo person fizik rezident në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për të ardhurat që i realizon në vend dhe jashtë vendit.
- Tatimi mbi fitim, tatimpaguesi i të ardhurave është një person juridik rezident i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe një njësi e përhershme afariste e një personi juridik të huaj për fitimin që ata e realizojnë nga kryerja e veprimtarisë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kompanitë e klasifikuara si tregtar të vegjël dhe mikro janë të liruara nga detyrimi për të paguar tatimin mbi fitimin për të ardhurat totale deri në 3,000,000 denarë. Kompanitë tregtare që gjatë vitit realizojnë të ardhura totale nga 3,000,001 deri në 6,000,000 denarë, u lejohet të zgjedhin regjimin modelin e tatimeve, në mënyrë që të jenë në gjendje të paguajnë një tatim total mbi të hyrat prej 1%, në vend të tatimit mbi fitimin në masën 10%, siç parashikohet në zgjidhjen ekzistuese ligjore<sup>22</sup>.

### 2. Tatimet indirekte

---

<sup>21</sup> Për më shumë rreth tatimit personal mbi të ardhura në Maqedonin e Veriut shërbehuni me: Ministria e Financave, "Tatimi personal mbi të ardhura", 2021. <https://finance.gov.mk>

<sup>22</sup> Për më shumë rreth tatimit mbi fitim në Maqedonin e Veriut shërbehuni me: Ministria e Financave, "Tatimi mbi fitim", 2021. <https://finance.gov.mk>

- Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), si tatim i përgjithshëm i konsumit, llogaritet dhe paguhet në të gjitha fazat e prodhimit dhe tregëtisë, si dhe në të gjithë sektorin e shërbimeve. Objekt i tatimit mbi vlerën e shtuar është qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve të kryera me kompensim në vend nga tatimpaguesi në kuadër të veprimtarisë së tij ekonomike dhe importi i mallrave<sup>23</sup>. Norma e përgjithshme tatimore e tatimit mbi vlerën e shtuar është 18%, ndërsa norma preferenciale prej 5%.

### 3. Tatimet në pasuri

- Tatimi në pronë paguhet për pasuritë e paluajtshme, tatimpagues janë personat juridik dhe ato fizik që zotrojnë pronë. Normat e tatimit në pronë janë proporcionale dhe variojnë nga 0.10% në 0.20%. Ato mund të përcaktohen nga lloji i pronës, kurse tatimi në pronë për tokën bujqësore që nuk përdoret për prodhim bujqësor mund të rritet nga tre në pesë herë në krahasim me normat bazë<sup>24</sup>.
- Tatimi në trashëgimi dhe në dhuratë paguhet në paluajtshmërinë dhe të drejtën e shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme, të cilën trashëgimtarët ose marrësit e dhuratave e trashëgojnë, përkatësisht e marrin në bazë të Ligjit për trashëgimi, gjegjësisht marrëveshjes së dhurimit. Tatimi mbi trashëgiminë dhe dhuratën për një tatimpagues të urdhrat të dytë të trashëgimisë llogaritet në norma 2% deri në 3%, dhe për një tatimpagues të rendit të tretë të trashëgimisë ose një tatimpagues që nuk ka lidhje me trashëgiminë, tatimi llogaritet në norma prej 4% deri në 5%.

### 4. Kontributet për sigurimet shoqërore

- Mjetet nga kontributet janë detyra publike të kontrolluara nga Ministria e Financave dhe janë në dispozicion të institucioneve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të krijuara me ligje që rregullojnë sistemin e sigurimeve të detyrueshme shoqërore, për qëllime të përcaktuara në përputhje me ato ligje. Sigurimi i detyrueshëm shoqëror përfshin kontributet për sigurimi pensional dhe invalidor në bazë të pagesës aktuale, sigurimin e detyrueshëm pensional me

<sup>23</sup> Për më shumë rreth ligjit mbi TVSH-në, në Maqedoni shërbehuni me: Gazeta Zyrtare e RM 44/99, ... 275/19, "Ligji për tatimin mbi vlerën e shtuar".

<sup>24</sup> Për më shumë rreth tatimit në pasuri në Maqedonin e Veriut shërbehuni me: Ministria e Financave, "Tatimi në pasuri", 2021. <https://finance.gov.mk>

financim të plotë, kohëzgjatjen e sigurimit që konsiderohet me kohëzgjatje të shtuar, si dhe sigurimin shëndetësor dhe të papunësisë<sup>25</sup>.

Tabela më poshtë paraqet normat tatimore aktuale në Maqedonin e Veriut

**Tabela 1 : Struktura aktuale e tatimeve në Maqedoninë e Veriut**

Tatimet	
Tatimi në fitim	10%
Tatimi në të ardhura personale	10%
Tatimi mbi vlerën e shtuar	18%, e përgjithëshme dhe 5%, preferenciale
Tatimet mbi pronësinë	0,10% deri 0,20%
Tatimet e trashigimisë dhe dhuratës	2% deri 3%
Tatimet e shitjes së pasurisë të paluajtshme	2% deri 4%
<i>Burimi: Ministria e Financave</i>	

Pra, vendet si Maqedonia e Veriut që synojnë integrimin në Bashkimin Evropian duhet t'ju përshtaten standardeve të BE-së, në kontekst të implementimit të normave më të larta tatimore që do i mundësojnë Maqedonisë së Veriut edhe gjenerimin e të ardhurave më të larta tatimore karshi vendeve që aktualisht janë pjesë e BE-së (këto vende gëzojnë dyfishin e të ardhurave tatimore).

## 2.2. Politikat tatimore në Maqedoninë e Veriut në raport me direktivën e Bashkimit Evropian

Strategjia e Maqedonisë Veriore për një politik tatimore me norma të ulta të tatimeve me objektivin për të stimuluar investimet e huaja në vend nga njëra anë, kurse nga ana tjetër një tatim i sheshtë për të gjitha të ardhurat personale kanë zvogluar dukshëm të ardhurat nga tatimet si pjesë e PBB-së. Tatimet aktuale në Maqedoninë e Veriut kanë rezultuar që vendi ynë të gjeneroj të ardhura më të ulta në krahasim me shtete fqinje dhe vendeve tjera evropiane

**Tabela 2 : Normat e tatimeve në vendet e Bashkimit Evropian**

	Mesatarj	A	Ç	Gj	G	It	SI
	a e BE-së	ustria	ekia	ermania	reqia	alia	lovakia

<sup>25</sup> Për më shumë rreth kontributeve në Maqedonin e Veriut shërbehuni me: Ministria e Financave, "Kontributet", 2021. <https://finance.gov.mk>

Tatimi në të ardhura	39.4% max	0 %-50% progresiv	1 5% i sheshtë	1 4%-47.5% progresiv	2 2%-55% progresiv	2 3%-47.2% progresiv	1 9%-25% progresiv
Tatimi në fitim	16%	1 7.2%	2 0.2%	1 6.8%	1 5.1%	1 9.5%	2 3,3%
TVSH	21.5%	2 0% dhe 10%	2 1% dhe 10%	1 9% dhe 7%	2 4% dhe 6%	2 2% dhe 4%	2 0% dhe 10%
Kontributet	24.2%	3 0.6%	3 0.8%	2 5.5%	3 4.8%	2 8.5%	2 8.7%
<b>Burimi: OECD</b>							

Tabela mësipër tregon normat tatimore të Austrisë, Çekisë, Gjermanisë, Greqisë, Italisë dhe Sllovakisë, përfshirë edhe normat mesatare të tatimeve të BE-së. Edhe pse në vendet e paraqitura në tabelë ekziston një dallim në nivelin e shkallës së tatimeve, përsëri këto vende janë afër mesatares së Bashkimit Evropian.

**Tabela 3 : Normat e tatimeve në vendet e rajonit**

	M aqedonia	Sër bia	S hqipëria	K osova	Bul lgaria	Kro acia	Sll ovenia
Tatimi në të ardhura	10 %- i sheshtë	10 %-20%	1 3%-23% progresiv	4 %-10% progresiv	10 % - i sheshtë	24 %-36% progresiv	16- 50% progresiv
Tatimi në fitim	10 % i sheshtë	15 % i sheshtë	0- 15% progresiv	1 0% i sheshtë	10 % i sheshtë	12- 18% progresiv	19 % i sheshtë
TVSH	18 % dhe 5%	20 % & 10%	2 0% & 6%	1 8% & 8%	20 % & 9%	25 % & 13 %	22 % & 9.5%
Kontributet	28 %	37. 8%	2 7.9%	1 0%	23. 7%-24,4%	37. 2%	38. 2%
<b>Burimi: OECD</b>							

Normat më të ulta të barrës tatimore janë të pranishëm në vendet më pak të zhvilluara sikurse në, Maqedoni, Bullgari, Shqipëri dhe Kosovë, e që njëherit janë shumë larg nga mesatarja e BE-së. Këto të fundit, për gjenerimin e të ardhurave nga tatimet kanë nevojë për një sistem tatimor më optimal, që do të thotë se ndërhyrjet në sistemin tatimor janë më se të domosdoshme. Krahasimi i normave tatimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendet

e Bashkimit Evropian na bën me dije se, Maqedonia e Veriut ka shkallën më të ulët të tatimit se të gjitha vendet e Bashkimit Evropian.

### 2.2.1. Të ardhurat nga tatimet në raport me PBB-në, në vendet e BE-së, dhe Maqedonisë së Veriut

Për dhjetë vitet e fundit arkëtimi i të ardhurave si pjesë e PBB-së, në Maqedoninë e Veriut ka qenë në ulje e sipër, ndërkohë që tani është ndër më të ulëtat në rajon. Ndërmjet viteve 2007 - 2016, të ardhurat e qeverisë qendrore u ulën nga 32 %, e PBB-së, në 28 %, pasi të ardhurat e qeverisë së përgjithshme gjithashtu u ulën, në 30.3 %, të PBB-së. Kjo është shumë më poshtë se mesatarja e BE-së, prej 45%<sup>26</sup>.

**Tabela 4 : Të ardhurat nga tatimet në vendet e BE-së dhe Maqedoninë e Veriut, si përqindje e PBB-së**

	2017	2018	2019
Danimarka	46.5	45.1	46.9
Belgjika	47.1	47.1	45.9
Spanja	34.7	35.4	35.4
UK	35.2	35.2	35.3
Islanda	37.6	37.2	35.8
Franca	48.3	48.2	47.4
Kroacia	37.7	38.3	38.7
Sllovenia	37.6	37.8	37.7
Bullgaria	29.4	30.0	30.3
<b>Maqedonia</b>	<b>25.5%</b>	<b>25.85%</b>	<b>25.89%</b>
Mesatarja e BE	41.4%	41.6%	41.6%
<b>Burim: Eurostat</b>			

Në tabelën mësipër kemi paraqitur të ardhurat nga tatimet të disa vendeve të Bashkimit Evropian dhe Maqedonisë së Veriut për periudhën 2017 - 2019. Të ardhurat nga tatimet në Maqedoninë e Veriut janë për 62 %, më të ulta në krahasim me mesataren e Bashkimit

<sup>26</sup> Për më shumë rreth të ardhurave nga tatimet si përqindje e PBB-së, shërbehuni me: International Bank for Reconstruction and Development, The World Bank, "Rishikimi i financave publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut", Washington DC, fq. 66, 2018



Evropian, e gjithë kjo si rezultat i normave të ulta të tatimit mbi fitim dhe tatimit mbi të ardhurat personale.

### 2.3. Treguesit statistikor të gjenerimit të të ardhurave publike nga tatimet direkte dhe indirekte në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Tabela në vijim tregon gjenerimin e të ardhurave tatimore në Maqedoninë e Veriut në raport me PBB-në , në një seri kohore duke filluar nga viti 2006 - 2020.

**Tabela 5 : Të ardhurat nga tatimet si përqindje e PBB-së, në RMV për periudhën 2006-2020**

	006	007	008	009	010	011	012	013	014	015	016	017	018	019	020
<i>at. në Fit.</i>	.708	.898	.579	.434	.690	.888	.652	.421	.060	2.024	0.768	1.353	4.745	1.554	0.496
<i>. në të AP</i>	.414	.892	8.696	.710	.872	.513	.553	0.254	2.320	2.910	4.205	5.263	7.559	8.705	8.625
<i>VSH</i>	7.239	2.962	6.173	5.173	7.694	2.224	8.469	9.835	3.860	1.694	5.949	7.870	9.254	2.059	6.892
<i>kciza</i>	2.174	3.265	4.276	4.533	4.925	5.513	6.596	5.990	7.392	9.783	2.215	3.093	5.092	6.087	3.400
<i>ogana</i>	.420	.199	.275	.229	.712	.779	.067	.255	.223	.330	.761	.175	.604	.033	.734
<i>ontributet</i>	0.766	3.457	8.249	8.837	8.687	9.759	0.765	2.458	4.185	7.900	0.313	2.890	6.538	2.166	8.633
<i>otali</i>	8.721	00.67	12.24	06.91	08.581	14.676	13.102	17.213	27.04	38.64	48.106	57.537	70.99	78.895	85.067
<i>PB në mil. Den</i>	34.840	72.889	14.890	14.622	37.296	64.187	66.703	01.891	27.631	58.240	98.881	18.106	60.878	89.425	64.200

	6.5%	7.0%	7.1%	5.8%	4.8%	4.7%	4.2%	3.4%	4.1%	4.8%	4.7%	5.5%	5.9%	5.9%	7.08%
<i>Burimi: kalkulim i autorit</i>															

Nga të dhënat e paraqitura vërehet se, të hyrat nga tatimet në periudhën e analizuar nuk janë të barabarta, ato variojnë nga 23%, deri në 27%. Nga viti 2008 - 2014, gjenerimi i të ardhurave si pjesë e PBB-së, në Maqedoninë e Veriut ka qenë në ulje, kurse nga viti 2014, deri në vitin 2020, ka pasur një rritje të ulët, mesatarisht 1.1%. Mes viteve të analizuara nga 2006 – 2020, të ardhurat me të ulta nga tatimet dhe kontributet në raport me PBB-në, kanë qenë në vitin 2013, edhe atë me 23.4%, kurse të ardhurat më të larta të mbledhura nga tatimet dhe kontributet kanë qenë në vitin 2008, me 27.1% të PBB-së. Këto të ardhura nga tatimet dhe kontributet janë shumë poshtë mesatares së BE-së, respektivisht prej 41.6% që rezulton nga aplikimi i normave të ulta tatimore në Maqedoninë e Veriut.

### 2.3.1. Të ardhurat nga tatimi i të ardhurave personale

Tatimi i të ardhurave personale në sistemin tatimor të Maqedonisë së Veriut përdoret për të tatimuar të ardhurat totale të tatimpaguesit nga të gjithë të ardhurat neto të fituara nga burime të ndyshme. Në Maqedoninë e Veriut aplikohet tatimi i sheshtë me një shkallë prej 10%. Në vijim, do të paraqesëm në mënyrë kronologjike të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale si përqindje e PBB-së, dhe si përqindje e të ardhurave totale nga tatimet.

**Tabela 6 : Të ardhurat nga tatimi i të ardhurave personale në Maqedoninë e Veriut, si përqindje e PBB-së dhe si përqindje e të ardhurave totale nga tatimet, për periudhën 2006-2020**

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Si % e PBB-së	2.5	2.4	2.1	2.1	2.0	2.0	2.0	2.0	2.0	2.3	2.3	2.4	2.6	2.7	2.8
Si % e tot. të tat.	9.4	8.8	7.7	8.1	8.1	8.2	8.4	8.7	9.6	9.3	9.5	9.6	10.2	10.0	10.0

*Burimi: Ministria e financave*

Në tabelen më lartë janë paraqitur të ardhurat nga tatimi në të ardhura personale në raport me PBB-në, dhe si përqindje e të ardhurave totale nga tatimet për periudhën 2006 - 2020. Ajo që mundemi të konstatojmë është se, zëvendësimi i normës tatimore nga 12% në një tatim të sheshtë prej 10% në vitin 2006, ka rezultuar me një rritje të të ardhurave nga tatimi personal përgjatë periudhes 2007-2013, kurse nga viti 2014 kemi një rritje të moderuar. Vlera mesatare e të ardhurave nga të ardhurat personale si përqindje e PBB-së, për vitet e analizuara është 2.30 %, me një minimum prej 2.0% gjatë viteve 2010-2013, dhe me një maksimum prej 2.80%, në vitin 2020. Pjesëmarrja më e madhe e tatimit në të ardhura personale në gjithsej të ardhurat tatimore është shënuar në vitin 2020, në vlerë prej 18.625 milionë denarë, ose 10.0 % nga të ardhurat totale, ndërsa më e ulëta është shënuar në vitin 2008, në vlerë prej 8.696 milionë denarë, ose 7.7% nga të ardhurat totale.

Maqedonia e Veriut ka hapësirë për të rritur shkallen e tatimit në të ardhurat personale. Aktualisht tatimet mbi të ardhurat personale bëjnë pjesë me një mesatare prej 9.4% në të ardhurat e përgjithshme dhe 2.3% në raport me PBB-në e vendit, e që njëherit është shumë më e ulët nga mesatarja e BE-së, e cila është 9.8%. E gjithë kjo, përshkak të nivelit të ulët të tatimit që është prezent nga viti 2008, me 10% dhe mungesës së tatimit progresiv. Një normë më e lartë marginale (duke qëndruar në kornizat e normave tatimore të vendeve fqinje), mbi tatimin e të ardhurave personale do t'i ofronte Maqedonisë së Veriut shumë përfitime, mirëpo reformat në sistemin tatimor, respektivisht rritja e normës tatimore duhet të shoqërohet edhe me një sistem kontrolli, për të kontrolluar evazionet fiskale të mundëshme si rezultat i barës së re tatimore.

Pra, një normë më e lartë e tatimit mbi të ardhurat personale do të gjeneroj të ardhura tatimore më të larta dhe do ta bëj sistemin tatimor më progresiv. Një sistem tatimor më optimal nvaret nga qeveria e Maqedonisë së Veriut, respektivisht se si ato do t'i mbledhin të ardhurat nga tatimet dhe a do të jenë në gjendje shtetasit e maqedonisë të paguajnë tatim me një normë më të lartë se ajo aktuale (prej 10%).

### **2.3.2. Të ardhurat nga tatimi mbi fitim**

Tatimi mbi fitim paguhet nga personat juridik për fitimet që ato realizojnë nga bizneset në territorin e Maqedonisë së Veriut. Aktualisht, vendi ynë ka një normë tatimore të sheshtë me një shkallë prej 10%. Për më tepër, tatimi mbi fitim luan një rol të rëndësishëm në sistemin tatimor të Maqedonisë së Veriut, jo vetëm për fitimet që ai gjeneron, por njëkohësisht ai ndikon edhe në mjedisin biznesor në vend. Në vijim, do të shohem të ardhurat nga tatimi mbi fitim në raport me PBB-në, dhe si përqindje e totalit të tatimeve.

***Tabela 7 : Të ardhura tnga tatimi mbi fitim në Maqedoninë e Veriut, si përqindje e PBB-së, dhe si përqindje e të ardhurave totale nga tatimet, për periudhën 2006-2020***

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Si % e PBB-së	1.4	1.6	2.1	1.1	0.8	0.8	0.2	0.9	1.0	2.2	1.8	1.8	2.2	1.6	1.6
Si % e tot. të tat.	5.3	5.8	7.6	4.1	3.3	3.4	3.2	3.7	3.9	8.6	7.2	7.2	8.6	6.4	5.6

*Burimi: Ministria e financave*

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën më sipër vërehet se, të ardhurat nga tatimi mbi fitim në periudhën e analizuar 2006-2020, nuk janë të barabarta, gjegjësisht variojnë nga 3.652 milionë denarë në vitin 2012, ose 0.8 % në raport me PBB-në, (shuma më të ulët si rezultat i aplikimit të normës së sheshtë), kurse në vitin 2015 është realizuar shuma më e lartë me 12.024 milion denar, ose 2.2% në raport me PBB-sën. Të ardhurat më të larta nga tatimi mbi fitim si përqindje e totalit të të ardhurave, Maqedonia e Veriut i ka realizuar në vitin 2015 me 8.6 %, kurse më të ulta në vitin 2012 me 3.2% në raport me totalin e tatimeve.

Për më tepër, në vitin 2018 mund të veçohet një tatimpagues i cili ka pasur statusin e përdoruesit të TIDZ-së, sipas regjistrave të PRO-së, i cili gjatë vitit 2018 ka bërë një pagesë në vlerë prej mbi 2.3 miliardë denarë të tatimit mbi fitim - pagesë kjo, që nuk u mbledh në vitet tjera. Pjesëmarrja e tatimit mbi fitim në vitin 2018 ka qenë me 12.8% në totalin e përgjithshëm të të ardhurave nga tatimet, kurse në vitin e fundit të analizuar 2020 tatimi në fitim merë pjesë 5.6%, në totalin e përgjithshëm të të ardhurave nga tatimet.

Tatimi mbi fitimin në Maqedonin e Veriut ka një normë të ulët prej 10 %, dhe stimulon investimet sikurse zbritjen për fitimet që rinvestohen. Kjo e fundit, në njërin anë mund të inkurajon shumëkombëset që t'i vendosin filialet e tyre në Maqedoninë e Veriut, kurse nga ana tjetër norma e ulët e tatimit mbi fitimin rezulton me arkëtim të ulët të të ardhurave, duke kontribuar mesatarisht me 7.5 %, në të ardhurat e përgjithshme tatimore.

Pra, Maqedonia e Veriut ka hapësirë që të rrit normën e tatimit mbi fitim (duke qëndrur në kufirin e normave tatimore të vendeve fqinje) - rritje kjo, që do të mundëson që vendi ynë të

mbledh më shumë të ardhura dhe njëkohësisht të mbetet një destinacion konkurrues për investimet e huaja.

### 2.3.3. Të ardhurat nga tatimi i vlerës së shtuar (TVSH)

Ndonëse akoma nuk po shqyrtohet si mundësi nga qeveria e Maqedonisë së Veriut, mirëpo vendi ynë mund të arkëton akoma më shumë të ardhura nga TVSH-ja, përmes zgjerimit të bazës tatimore, rrjedhimisht lëvizjes drejt një norme të vetme të TVSH-së, dhe zbatimit të të njëjtës. Raporti i të ardhurave nga TVSH-ja, ose raporti i efikasitetit C79 për Maqedoninë e Veriut, lëviz rreth 0.6%, që është i ulët në krahasim me homologët e WB6. Kjo sugjeron që të ardhurat po humbasin përmes përjashtimeve dhe tarifave të reduktuara, si dhe shmangies dhe evazionit fiskal. Rreth 36 % e shportës së konsumit tatimohet me normën standarde të TVSH-së, prej 18 %, pjesa e mbetur tatimohet me një normë të reduktuar prej 5 %<sup>27</sup>. Në vijim, sjellim të ardhurat nga TVSH-ja, si përqindje e PBB-së, dhe si përqindje e të ardhurave totale nga tatimet në Maqedoninë e Veriut.

**Tabela 8 : Të ardhurat nga tatimi i vlerës së shtuar (TVSH) në Maqedoninë e Veriut, si përqindje e PBB-së dhe si përqindje e të ardhurave totale nga tatimet, për periudhën 2006-2020**

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Si % e PBB-së	8.1	8.8	8.7	8.5	8.6	9.1	8.2	7.9	8.3	7.5	7.7	7.7	7.4	7.5	7.0
Si % e tot. të tat.	30	32	32	32	35	37	34	34	34	30	31	30	28	29	25

Burimi: Ministria e financave

<sup>27</sup> Për më shumë rreth TVSH-së në Maqedoninë e Veriut shërbehuni me: Banka Botrore, "Rishikimi i Financave Publike", fq. 76, 2019.

Në tabelen më sipër janë paraqitur të ardhurat nga tatimi i vlerës së shtuar (TVSH), si përqindje e PBB-së, dhe si përqindje e të ardhurave totale nga tatimet për periudhën 2006-2020. Vlera mesatare e të ardhurave nga TVSH-ja, si përqindje e PBB-së, për vitet e analizuara është 8.06%. Minimumi prej 7.0% është shënuar në vitin 2020, kurse maksimum prej 9.1% në vitin 2011. Pjesëmarrja më e madhe e tatimit në vlerën e shtuar në gjithsej të ardhurat tatimore është shënuar në vitin 2011, në vlerë prej 42.224 milionë denarë, ose 37 % (në totalin e të ardhurave nga tatimet indirekte dhe direkte), nga të ardhurat totale, ndërsa më e ulëta në vitin 2020, në vlerë prej 46.892 milionë denarë, ose 25% nga të ardhurat totale.

Në terma afatgjatë, një reformë më gjithëpërfshirëse mund të zgjerojë bazën e TVSH-së, duke hequr trajtimin preferencial të mallrave dhe shërbimeve që nuk u drejtohen të varfërve. Heqja e trajtimit preferencial për disa nga mallrat dhe shërbimet mund të sjellë 2 miliardë denarë shtesë në të ardhura nga TVSH-ja, ose rreth 0,5 % e PBB-së. Pjesa më e madhe e kësaj rritjeje shtesë do rezultonte nga heqja e trajtimit preferencial për kompjuterë dhe programe kompjuterike, akomodim në hotel dhe lojëra të fatit. Vlerësimi përfshin uljen e konsumit të këtyre mallrave dhe shërbimeve nga rritja e TVSH-së, por nuk përfshin humbjet në të ardhura për shkak të evazionit fiskal<sup>28</sup>.

Pra, të ardhurat e ulëta nga tatimet në rastin e Maqedonisë së Veriut rezultojnë nga implementimi i barrës së ulët tatimore - implementim ky, që e rangon vendin tonë shumë ulët në krahasim me shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe vendet evropiane. Duke ndjekur direktiven e BE-së, për një sistem tatimor më optimal nënkupton se reformat tatimore në Maqedoninë e Veriut janë të nevojshme dhe të domosdoshme, rrjedhimisht rritja e normave tatimore do të rriste të ardhurat dhe do të inkuadroj progresivitet më të madh në sistemin tatimor të Maqedonisë së Veriut.

## **2.4. Rekomandimet e Bankës Botërore për një sistem tatimor më optimal në Maqedoninë e Veriut**

Rekomandimet e Bankës Botërore për një sistem tatimor më optimal mund të rangohen sikurse në vijim:<sup>29</sup>

---

<sup>28</sup> Për më shumë rreth TVSH-së, në Maqedoninë e Veriut shërbehuni me: Banka Botërore, "*Rishikimi i Financave Publike*", fq. 77, 2019.

<sup>29</sup> Për më shumë rreth rekomandimeve të Bankës Botërore për sistemin tatimor në RMV-ë, shërbehuni me: Banka Botërore, "*Vështrim i përgjithshëm i financave publike në Maqedoni*", 2018.

- Miratimi i një strukture më progresive të tatimit mbi të ardhurat personale me norma marginale më të larta, për fituesit me të ardhura të larta. Kjo do të rriste gjenerimin e të ardhurave dhe do ta bënte tatimin më të drejtë.
- Zgjerimi i bazës së tatimit mbi vlerën e shtuar nëpërmjet heqjes së trajtimit preferencial të mallrave dhe shërbimeve të përzgjedhura. Gama e gjerë e tarifave të reduktuara krijon mundësi për abuzim, ndërsa një TVSH-ë, standarde me bazë të gjerë përmirëson efikasitetin ekonomik dhe administrativ. TVSH-ja, është një mjet rishpërndarës joefektiv.
- Rritja e akcizës për duhanin, qymyrin dhe naftën. Kjo do të çojë në të ardhura më të larta dhe përmirësime në rezultate të tjera sociale, përfshirë shëndetësinë dhe ndotjen.
- Eksplorimi nëse strategjitë e qeverisë për nxitjen e investimeve kanë qenë të dobishme nëpërmjet analizës kosto-përfitim. Për të përcaktuar nëse mbështetja për TIDZ-të, është një përdorim efikas i të ardhurave publike duhet bërë një analizë. Këto stimuj rezultojnë në kosto fiskale neto për qeverinë për sa i përket të ardhurave tatimore të hedhura, granteve, kostove administrative dhe kostove të pajtueshmërisë, efekteve të shtrembërimit të uljes së të ardhurave dhe shpërndarjes së deformuar të burimeve nga stimulimi.
- Vlerësimi se cilat stimuj tatimor duhet të ruhen, në bazë të rishikimit të shpenzimeve tatimore.
- Rritja e normës së tatimit mbi fitim, për ta afruar atë me shtetet e rajonit (afër 15%). Në këtë mënyrë do të rriten të ardhurat dhe do të ribalancohet barra tatimore ndërmjet kapitalit dhe punës.

Së fundmi, Maqedonia e Veriut ka hapësirë për të mbledhur më shumë të ardhura nga tatimet, ngase normat standarte të tatimeve janë shumë poshtë mesatares së Bashkimit Evropian (siç është norma e tatimit mbi të ardhurave personale dhe tatimit mbi fitim të cilat janë me një normë prej 10 përqind një normë e sheshtë që rezulton që Maqedonia e Veriut të ketë të ardhura nga tatimet direkte më të ulta në rajon). Kjo e fundit, na bën me dije se,

Maqedonia e Veriut duhet të marr në konsideratë rekomandimet e Bankes Botrore për të krijuar një sistem tatimor më optimal, rrjedhimisht me norma më të larta të tatimeve që do të mundësoj edhe përshtatjen me vendet e rajonit dhe Bashkimit Evropian.

### **KAPITULLI III : POLITIKAT TATIMORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NË KRAHASIM ME REPUBLIKËN E SLLOVENISË**



*"Rritja e tatimeve është katër herë më e suksesshme, se sa reduktimi i shpenzimeve" (Igor Lukšič).*

### 3.1. Reformat tatimore dhe sistemi tatimor në Republikën e Sllovenisë

Një pjesë e rëndësishme e sistemit aktual tatimor të Sllovenisë u formua në fillim të vitit 1990, duke përfshirë tatimin e ri mbi të ardhurat personale dhe mbi të ardhurat e korporatave. Gjatë vitit 1990 u realizuan disa ndërhyrje në normat tatimore, ndërsa në vitin 2004 nga parlamenti i Sllovenisë u miratuan ligjet e reja për tatimin mbi të ardhurat publike dhe tatimin mbi fitim - ligje këto, që hyrën në fuqi në janar në vitin 2005<sup>30</sup>.

Sllovenia ka parë disa faza të rëndësishme në zhvillimin e sistemit tatimor, gjegjësisht pas pavarësisë Sllovenia bëri ndërhyrje rrënjësore në sistemin e saj tatimor me objektivin për t'u përshtatur me ato të vendeve të zhvilluara, duke i larguar kështu disa lloje të tatimeve direkte dhe kontributeve, si dhe duke prezantuar tatimin mbi fitim si tatim kryesor për korporatat, kurse tatimin mbi të ardhurat personale si tatim kryesor për personat fizik.

Për rrjedhore, në vitin 1995 u inkorporua tatimi mjedisor, kurse një vit më vonë u bë një reformë e plotë në organizimin të mbledhjes së tatimeve dhe monitorimin e pagesave të tatimeve. U krijua një administratë e vetme tatimore, e cila kombinonte Administratën e të ardhurave publike të Republikës së Sllovenisë dhe Agjencionin për transaksionet e pagesave. Paraprakisht, Administrata e të ardhurave publike kishte mbledhur dhe monitoruar tatimet e paguara nga personat fizik, ndërsa Agjencioni për transaksione të pagesave kishte mbledhur dhe monitoruar tatimet e korporatave - kombinim ky, që mundësoi mbledhjen dhe monitorimin më efikas të tatimeve. Për më tej, u inkorporuan numrat e ID-së, dhe bashkë me ta edhe regjistri qendror i personave të tatueshëm, duke përfshirë edhe ndryshimin e fundit më të rëndësishëm që u zbatua në vitet 1990, e që kishte të bëjë me inkorporimin e TVSH-së. Deri më sot, nivelet e tatimeve të TVSH-së, janë rritur dy herë, edhe atë së pari në vitin 2005, dhe në vitin 2013<sup>31</sup>.

Periudha e dytë e rëndësishme me reforma tatimore në Slloveni ndodhi në vitet 2004 - 2006. Shumica e ndryshimeve u zbatuan në vitin 2005 (më vonë pasuan vetëm korrigjimet), e kishin të bënin me tatimin mbi të ardhurat personale, duke mos përjashtuar edhe ndryshimet në: zgjerimin e të ardhurave, lehtësimeve në tatimet direkte dhe indirekte, reduktimin e numrit

<sup>30</sup> Për më shumë rreth reformave në Sloveni shërbehuni me: M.Boris, V.Miroslav, B.Ali, Č.Mitja, " *Reforma e tatimit mbi të ardhurat në Sloveni: A duhet të ketë mbizotëruar tatimi i sheshtë?*", fq. 1, 2007.

<http://www.ier.si/files/Working%20paper-34.pdf>

<sup>31</sup> Për më shumë rreth reformave në Sloveni shërbehuni me: Institute of Public Finance, Zagreb, Smičklasova 21 " *Tax reforms, experiences and perspectives*", fq. 150, 2014. [http://www.ijf.hr/upload/files/file/knjige/tax\\_reform\\_proceedings.pdf](http://www.ijf.hr/upload/files/file/knjige/tax_reform_proceedings.pdf)

të grupeve tatimore, si dhe uljen e normës së tatimit për grupin më të ulët. Shpenzimet e sistemit tatimor për tatimin mbi fitim u përcaktuan më qartë, normat e amortizimit u ulën. Lehtësimi i investimeve praktikisht u eliminua, por shpejt u rivendos me kufizime më të rrepta. Krahas këtyre ndryshimeve të mëdha, në shtator të vitit 2004 u eliminua ngarkesa e pagave më të ulëta në formën e tatimit mbi pagat, dhe u eliminua tatimi në totalin e bilancit të bankave dhe institucioneve të kursimit.

Në vitin 2005, qeveria krijoi një ekip të posaçëm tatimor që përgatiti propozime për rregullimet e reformës së vitit 2004. Ndryshimet më të rëndësishme kishin të bënin me tatimin mbi të ardhurat personale, me sistemin caktues të tatimit për disa lloje të të ardhurave dhe ndryshimet në disa lloje të lehtësimit tatimor. Procesi tatimor u thjeshtua, norma e interesit të vonuar u zvoglua, u ndryshua mënyra e shlyerjes së borxhit dhe u zgjat periudha për shlyerjen e borxhit me këste.

Periudha e tretë e reformave tatimore në Sloveni erdhi në vitin 2010, ku me ç'rast u prezantuan një sërë masash të cilat synonin kryesisht nxitjen dhe mbështetjen e ekonomisë, e që më vonë, respektivisht në vitin 2013 u zëvendësuan nga një rregullim i sërishëm që synonte konsolidimin fiskal (në vitin 2010, norma tatimore për tatimin mbi fitim ishte planifikuar të ulej gradualisht në 15%, por ndryshimet e prezantuara në vitin 2013 e çuan normën tatimore në 17%)<sup>32</sup>.

Në vitin 2019 - 2020, Slovenia pësoi sërish në reforma tatimore që rezultuan nga ndikimi negativ që solli kriza shëndetësore COVID-19 në ekonomi, ku me ç'rast Sllovenia për të forcuar stimujt e punës për të ardhura më të larta ndërhyri në sistemin tatimor, edhe atë:

- lehtësim shtesë tatimor të përgjithshëm (linear) për të ardhurat deri në 13.316,83 Euro, së bashku me një rritje prej 6% të lehtësimit të përgjithshëm tatimor;
- ulje të normave tatimore të tatimit mbi të ardhurat personale, respektivisht për grupin e dytë (nga 27%, në 26%) dhe grupin e tretë tatimor (nga 34%, në 33%), e që hyri në fuqi në vitin 2020, kurse norma kryesore e tatimeve mbeti e pandryshuar<sup>33</sup>.

Pra, sipas reformave të realizuara në sistemin tatimor të Sllovenisë konstatojmë se, edhe Sllovenia ka realizuar reforma të ngjajshme sikurse shumica e vendeve të Bashkimit Evropian.

---

<sup>32</sup> Për më shumë rreth reformave në Sloveni shërbehuni me: Institute of Public Finance, Zagreb, Smičiklasova 21 "Tax reforms, experiences and perspectives", fq. 152, 2014.

[http://www.ijf.hr/upload/files/file/knjige/tax\\_reform\\_proceedings.pdf](http://www.ijf.hr/upload/files/file/knjige/tax_reform_proceedings.pdf)

<sup>33</sup> Për më shumë rreth reformave të realizuara në vitin 2019-2020 në Slloveni shërbehuni me: OECD, "Economic policy reforms in Slovenia", 2021 <https://www.oecd-ilibrary.org/sites/e943aab0/en/index.html?itemId=/content/component/e943aab0-en>

Reformat tatimore të ndërmarra në Slloveni kanë efektuar pozitivisht si në rritjen e të ardhurave nga tatimet, ashtu edhe në stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik të vendit (fokusi kryesor i reformave tatimore në Slloveni ka qenë lehtësimet tatimore për personat me të ardhura të ulëta dhe zvoglimi i normave tatimore).

### **3.1.1. Sistemi aktual tatimor në Republikën e Sllovenisë**

Sistemi tatimor në Slloveni përbëhet nga një grup tatimesh që menaxhohen nga administrata e vendit, me qëllim të arritjes së objektivave fiskale, ekonomike dhe sociale. Po ashtu, sistemi tatimor i Sllovenisë është pjesë e rëndësishme e sistemit ekonomik dhe socio-politik, së bashku me kontributet e sigurimeve shoqërore, sistemet doganore dhe tarifatat e tjera, që formojnë sistemin fiskal të Sllovenisë.

Sistemi tatimor në Slloveni përbëhet nga tre grupe të tatimeve, edhe atë:<sup>34</sup>

1. Tatimet e drejtpërdrejta në të ardhura
2. Tatimet e drejtpërdrejta në pronë
3. Tatimet indirekte

#### **1. Tatimet e drejtpërdrejta në të ardhura**

Në këtë grup të tatimeve bëjnë pjesë:

- Tatimi mbi të ardhurat e korporatave;
- Dividenda;
- Interesi dhe të drejtat autoriale;
- Tatimi në tonazh;
- Tatimi mbi të ardhurat personale;
- Tatimi në fitim nga instrumentet derivuese;
- Tatimi mbi pagën;
- Tatimi mbi punën kontraktuese;
- Kontributet e sigurimeve shoqërore;
- Tatimi i fitimit nga lojërat e fatit;

Në vijim, shkurtimisht do të ndalemi në tatimin mbi fitim, dividendën dhe tatimin mbi të ardhurat personale të cilët konsiderohen si tatime më kryesore, e që njëherit kanë peshë më të madhe në gjenerimin e të ardhurave nga tatimet e drejtpërdrejta në të ardhura në Slloveni.

#### **Tatimi mbi fitim**

---

<sup>34</sup> Për më shumë reth sistemit tatimorë në Sloveni shërbehuni me : Ministry of Finance Slovenia, "Taxation in Slovenia", <https://www.gov.si/en/state-authorities/ministries/ministry-of-finance/>

Tatimi mbi fitim vendoset mbi fitimin e tatueshëm të korporatave me një normë prej 19%. Një normë e veçantë prej 0 % zbatohet në kushte të caktuara për fondet e investimeve, të pensioneve dhe tek shoqëritë e sigurimit për planet e pensionit. Nga 1 janari i vitit 2013 ekziston një regjim tatimi opsional me normë të sheshtë<sup>35</sup>.

## **Dividenta**

Një kompani që paguan dividendë mban tatimin me një normë prej 15% për çdo dividendë të shpërndarë për rezidentët dhe jorezidentët e Sllovenisë. Nëse marveshjet ndërkombëtare për shmangien e tatimit të dyfishtë përcaktojnë një normë tatimore të ndryshme nga ajo prej 15%, atëherë zbatohet norma tatimore nga marveshja.

## **Tatimi mbi të ardhurat personale**

Tatimi mbi të ardhurat personale bën dallimin ndërmjet gjashtë kategorive të të ardhurave, sikurse të ardhurat nga: punësimi, biznesi, bujqësia dhe pylltaria, qiratë dhe honoraret, kapitali, si dhe të ardhurat tjera që grumbullohen për personat që i nënshtrohen tatimit në Republikën e Sllovenisë.

Banorët i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat e tyre në mbarë botën (d.m.th. të ardhurat e realizuara në Slloveni, si dhe jashtë saj). Çdo individ trajtohet si një tatimpagues i veçantë. Nuk ka asnjë tatim për bashkëshortët apo familjen në tërësi.

Tatimi mbi të ardhurat nga kapitali (për interesat, dividendën dhe fitimet kapitale) dhe mbi të ardhurat nga qiraja, paguhet sipas një norme tatimore të sheshtë mbi të ardhurat, sikurse në vijim:

- interesi i marrë: 25 %;
- dividendët e marrë: 25 %;
- fitimet kapitale: 25 % për një periudhë mbajtje deri në 5 vjet, 15 % për një periudhë mbajtje nga 5 vjet, deri në 10 vjet, 10 % për një periudhë mbajtje nga 10 vjet, deri në 15 vjet, 5 % për një periudhë mbajtje nga 15 vjet, deri në 20 vjet, si dhe përjashtim nga tatimi për një periudhë mbajtje më të madhe se 20 vjet.

Baza vjetore e tatueshme llogaritet pasi të jenë zbritur kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe disa shtesa. Shuma neto tatimohet me norma progresive. Orari vjetor

---

<sup>35</sup> Për më shumë rreth tatimit mbi fitim në Sloveni shërbehuni me : Ministria Financës, "Taxation in Slovenia", fq 9, 2018.  
[https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation\\_in\\_Slovenia\\_2018.pdf](https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation_in_Slovenia_2018.pdf)

i normës tatimore është fikse dhe zbatohet për vitin pasardhës. Kjo i mundëson tatimpaguesit të përcaktoj detyrimin aktiv të tatimit mbi të ardhurat gjatë vitit tatimor<sup>36</sup>.

**Tabela 9: Normat progresive të tatimit personal varësisht nga shuma e të ardhurave personale (në Euro), në Slloveni**

Nga	Deri	Norma e tatimit
	8.021,34	16%
8.021,34	20.400,00	27%
20.400,00	48.000,00	34%
48.000,00	70.907,20	39%
70.907,20		50%

## 2. Tatimet e drejtpërdrejta në pronë

Në këtë grup bëjnë pjesë këto lloje të tatimeve:

- tatimi mbi trashëgimi dhe dhurata;
- tatimi mbi pronë;
- tatimi mbi anije;
- tatimi në qarkullim;
- tatimi mbi bilancin e gjendjes bankare.

Në vijim, shkurtimisht do të ndalemi në tatimin mbi trashigimi dhe dhurata, si dhe në tatimin mbi pronë të cilët konsiderohen si tatime më kryesore, e që njëherit kanë peshë më të madhe në gjenerimin e të ardhurave nga tatimet e drejtëpërdrejta në pronë në Slloveni.

### Tatimet në trashëgimi dhe dhurata

Tatimet në trashëgimi dhe dhurata zbatohen për transferimet e pronës dhe paguhet nga individë, ose persona juridik të së drejtës private, që kanë marrë pasuri në formë trashëgimie, ose dhurate.

Sipas marrëdhënies së tyre me një të ndjerë ose një dhurues, tatimpaguesit ndahen në katër kategori, si më poshtë:

- klasa I: të gjithë pasardhësit dhe bashkëshortët e drejtpërdrejtë;

<sup>36</sup> Për më shumë reth tatimit mbi të ardhurat personale në Slloveni shërbehuni me : Ministria Financës, "Taxation in Slovenia", fq 14, Februar 2018. [https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation\\_in\\_Slovenia\\_2018.pdf](https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation_in_Slovenia_2018.pdf)

- klasa II: prindërit, vëllezërit e motrat dhe pasardhësit e tyre;
- klasa III: gjyshërit; dhe
- klasa IV: të tjerët.

Tatimi vendoset në mënyrë progresive në varësi të vlerës së pasurisë dhe kategorisë, në të cilën klasifikohet lidhja me të ndjerin, ose dhuruesin. Përrjashtimet nga tatimi mbi trashëgimi dhe dhuratë përfshijnë: individët e klasifikuar në klasën I; fermerët që trashëgojnë tokën bujqësore, ose të gjithë fermën, si dhe personat juridik të së drejtës private, aktivitetet humanitare, arsimore, kulturore, bamirëse dhe aktivitet tjera të caktuara. Përrjashtohen nga tatimi pasuria e luajtshme deri në 5000 Euro<sup>37</sup>.

**Tabela 10: Normat tatimore të klasave në Slloveni**

Klasa	Norma
Klasa II	5% - 14%
Klasa III	8% - 17%
Klasa IV	12% - 39%

### Tatimi në pronë

Tatimi i pronës së paluajtshme i zbatuar me 1 Janar të vitit 2014, zëvendësoi të gjitha tatimet ekzistuese të pasurive të paluajtshme në Slloveni, duke hequr në këtë mënyrë të gjithë legjislacionin e mëparshëm. Që nga 1 Janari i vitit 2018, sistemi slloven i tatimit në pronë përbëhet nga dy lloje detyrimesh për posedimin e pronës së paluajtshme. Njëra është tatimi i pronës dhe tjetra është një detyrim që quhet "tatim për shfrytëzimin e tokës ndërtimore".

### 3. Tatimet indirekte

Në këtë grup bëjnë pjesë këto lloje të tatimeve:

- tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH);
- akcizat;

<sup>37</sup> Për më shumë reth tatimit të trashigimisë dhe dhuratave në Slloveni shërbehuni me : Ministria Financës, "Taxation in Slovenia", fq 23, Februar 2018. [https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation\\_in\\_Slovenia\\_2018.pdf](https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation_in_Slovenia_2018.pdf)

- tatimi mbi shërbimet e sigurimit;
- tatimi mbi transferimin e pronës së patundshme;
- tatimi mbi automjetet;
- doganat.

Në vijim, shkurtimisht do të ndalemi në tatimin mbi vlerën e shtuar dhe akcizën, të cilët konsiderohen si tatime më kryesore dhe që kanë peshë më të madhe në gjenerimin e të ardhurave nga tatimet indirekte në Slloveni.

### **Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH-ja)**

TVSH-ja paguhet në të gjitha furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të kryera nga një person i tatueshëm gjatë aktivitetit të tij ekonomik brenda territorit të Sllovenisë. Nëse blerësi dhe shitësi janë në Slloveni, atëherë shitësi ngarkon dhe paguan TVSH-në, për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, kurse nëse blerësi dhe shitësi janë në shtete të ndryshme anëtare të BE-së, blerësi ngarkon dhe paguan TVSH-në, për blerjen e mallrave.

Ekzistojnë dy norma të aplikueshme të TVSH-së, në Slloveni (normat aktuale aplikohen nga 1 korriku 2013), ajo standarde prej 22 % që zbatohet për të gjitha furnizimet e mallrave dhe shërbimeve që nuk i nënshtrohen normës së reduktuar ose përjashtimeve, dhe ajo e reduktuara prej 9.5 % që zbatohet për mallrat dhe shërbimet e përcaktuara në mënyrë specifike nga Ligji i TVSH-së. Mallrat dhe shërbimet që kanë normë të reduktuar janë:

- produktet;
- furnizimi me ujë;
- furnizimet me barna dhe pajisje mjekësore për përdorim personal të personave me aftësi të kufizuara;
- transporti i udhëtarëve dhe bagazhet e tyre personale;
- huazimet nga bibliotekat, gazetat dhe revista periodike;
- pranimi në ngjarjet kulturore dhe sportive;
- honoraret për shkrimtarët, kompozitorët dhe shërbimet e ofruara nga artistët interpretues;
- importi dhe furnizimi i disa veprave artistike, gjërat e koleksionistëve apo ato antike;
- sigurimi, ndërtimi, rinovimi dhe ndryshimi i banesave, si pjesë e politikës sociale;
- rinovimi dhe riparimi i banesave private, duke përjashtuar materialet që përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të vlerës së shërbimit të ofruar;
- pastrimi dhe pastrimi i dritareve në amvisëri private;
- furnizimet e kafshëve;
- mbrojtja e bimëve dhe shërbimet për përdorim në prodhimtarinë bujqësore;
- shfrytëzimi i objekteve sportive;

- furnizimi i shërbimeve nga sipërmarrësit dhe shërbimet e djegies, si dhe furnizimi i mallrave që lidhen me to;
- shërbimet e higjienës publike;
- riparimet e vogla të biçikletave, këpucëve dhe artikujve prej lëkure, veshjeve dhe lirive shtëpiake (përfshirë riparimin dhe alternimin);
- shërbimet e kujdesit shtëpiak si ndihma në shtëpi dhe kujdesi për të rinjtë, të moshuarit, të sëmurët ose invalidët;
- parukeritë;
- furnizimi me bimë të gjalla dhe lule të prera<sup>38</sup>.

## Akcizat

Mallrat që i nënshtrohen akcizës janë produktet e duhanit, pijet alkoolike, produktet energjetike (vajrat minerale, gazi natyror, qymyri dhe koksi) dhe energjia elektrike. Akciza paguhet në mallrat me akcizë të prodhuara në Slloveni, ose të importuara nga një shtet tjetër anëtar i BE-së, nëse ato janë të destinuara për konsum në Slloveni. Një prodhues, ose importues paguan akcizën nëse mallrat nuk janë të destinuara për konsum përfundimtar, prapseprap ato mund të vendosen nën një regjim pezullimi, e në këtë rast mallrat me akcizë mbeten nën mbikëqyrjen e zyrës financiare kompetente, ku me ç'rast akciza paguhet kur malli del nga regjimi i pezullimit.<sup>39</sup>

Pra, *“një sistem tatimor i projektuar mirë është gurthemeli i një sistemi tatimor që mund të prodhojë efektivisht rritje ekonomike gjithëpërfshirëse”*. Sllovenia posedon sistem tatimor të dizajnuar ngjajshëm sikurse shumica e shteteve tjera të Bashkimit Evropian. Ndonëse sistemi tatimor në Slloveni është i përafërt me shtetet e BE-së, prapseprap Sllovenia ka nevojë për reforma tatimore, me moton *“rritja e të ardhurave neto për punonjësit dhe bërja e tregut të punës më konkurrues”*. Dispozitat për lehtësimin e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi ndjekin sugjerimet e fundit të OECD-së, edhe pse ndryshimet në tatimin mbi të ardhurat dhe fitimet kapitale duhet të konsiderohen me kujdes përpara zbatimit.

<sup>38</sup> Për më shumë rreth TVSH- së, në Slloveni shërbehuni me: Ministria e Financës, *“Taxation in Slovenia”*, fq. 25, 2018. [https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation\\_in\\_Slovenia\\_2018.pdf](https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation_in_Slovenia_2018.pdf)

<sup>39</sup> Për më shumë rreth akcizës në Slloveni shërbehuni me: Ministria e Financës, *“Taxation in Slovenia”*, fq. 26, 2018. [https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation\\_in\\_Slovenia\\_2018.pdf](https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation_in_Slovenia_2018.pdf)



## 3.2. Tatimi mbi të ardhurat personale dhe tatimi në fitim në Republikën e Sllovenisë

### 3.2.1. Të ardhurat nga tatimi mbi fitim në Slloveni

Tatimi në fitim aplikohet në fitimin që e realizojnë kompanitë në Slloveni, ku norma e tatimit është 19%, kurse norma e veçantë prej 0% aplikohet në fondet investuese, pensionale, në shoqëritë e sigurimit në aspektin e planeve të pensionit dhe në disa lloje tjera të kompanive të përcaktuara me ligj. Në vijim do të paraqesëm në mënyrë kronologjike të ardhurat nga tatimi mbi fitim, si përqindje e PBB-së dhe si përqindje e të ardhurave totale nga tatimet.

**Tabela 11: Të ardhurat nga tatimi në fitim në Slloveni, si përqindje e PBB-së, dhe si përqindje e totalit të tatimeve, për periudhën 2006-2020**

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Si % e PBB-së	2.9	3.2	2.5	1.8	1.8	1.6	1.2	1.2	1.4	1.5	1.6	1.8	1.9	2.0	1.3
Si % e totalit të tatimeve	7.5	8.3	6.5	4.8	4.8	4.4	3.2	3.1	3.7	3.9	4.2	4.7	5.1	5.3	3.5

Burimi: Ministria e Financave

Nga tabela mësipër mund të verëjmë se, ekziston një tendencë rrënëse si në gjenerimin e të ardhurave nga tatimi në fitim në raport me PBB-në, ashtu edhe në pjesëmarrjen e totalit të tatimeve. Të ardhurat më të ulëta nga tatimi në fitim kanë qenë në vitin 2013 me një shumë prej 433 milion euro, ku me ç'rast tatimi në fitim merr pjesë me 1.2% si përqindje e PBB-së, kurse si përqindje e totalit të tatimev me vetëm 3.1%. Të ardhura më të larta nga tatimi në fitim janë regjistruar në vitin 2007 me një shumë prej 1.116 milion euro, ose me një pjesëmarje prej 3.2% në raport me PBB-në, ndërsa në raport me totalin e të ardhurave kjo përqindje arrin në 8.3%.

Pra, pas reformave tatimore të realizuara në Slloveni në vitin 2013, respektivisht uljen e tatimit në fitim në 17%, vërejmë një tendencë rrënëse në gjenerimin e të ardhurave nga tatimi në fitim. Ulja e normës tatimore në 17% në njërin anë ndikoi në uljen e të ardhurave nga tatimi në fitim, kurse në anën tjetër e bëri Slloveninë një vend të përshtatshëm për investime nga shoqëritë shumëkombëshe, duke e shndërruar në këtë mënyrë Slloveninë në një vend konkures në Ballkanin Perëndimor për investimet e huaja.

### 3.2.2. Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale në Slloveni

Tatimit mbi të ardhurat personale në Slloveni i nënshtrohen të gjithë banorët rezident dhe jorezident, ku njëherit çdo individ trajtohet si një tatimpagues i veçantë, respektivisht nuk ka asnjë tatim për bashkëshortët apo familjen në tërësi. Normat e tatimit mbi të ardhurat

personale variojnë nga 16% deri në 50%, pra në varësi të të ardhurave që disponon individit aplikohen 5 norma tatimore, sikurse: 16%, 27%, 34%, 39% dhe 50%. Për më tepër, në mënyrë kronologjike sjellim të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale si përqindje e PBB-së, dhe si përqindje e të ardhurave totale nga tatimet.

**Tabela 12: Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale në Slloveni, si përqindje e PBB-së, dhe si përqindje e totalit të tatimeve, për periudhën 2006-2020**

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Si % e PBB-së	5.6	5.5	5.8	5.7	5.5	5.5	5.6	5.1	5.0	5.1	5.2	5.1	5.4	5.3	5.4
Si % e totalit të tatimeve	14.6	14.3	15.3	15.3	14.6	14.8	14.9	13.6	13.5	13.6	13.9	13.7	14.3	14.1	14.6

Burimi: Ministria e Financave

Nga të dhënat e prezantuara në tabelën më sipër konstatojmë se, vlera mesatare e të ardhurave nga të ardhurat personale si përqindje e PBB-së, për vitet e analizuara është 5.4%, me një minimum prej 5.0%, në vitin 2014, dhe me një maksimum prej 5.8%, në vitin 2008. Pjesëmarrja më e madhe e të ardhurave nga tatimi personal në të ardhura, në gjithsej të ardhurat tatimore është shënuar në vitin 2012 në vlerë prej 2.040 milionë euro, ose 14,9 % nga të ardhurat totale, ndërsa më e ulëta në vitin 2014 në vlerë prej 1,896 milionë euro, ose 13,5 % nga të ardhurat totale tatimor.

Pra, normat e tatimit mbi të ardhurat personale në Slloveni janë më të larta në krahasim me shtetet tjera të Ballkanit Perëndimor - fakt ky, që i ka mundësuar Sllovenisë që përmes aplikimit të normave progresive tatimor mbi të ardhurat personale të gjeneron të ardhura të larta tatimore, e njëherit të kontribuon në zvoglimin e hendekut mes të pasurve dhe të varfërve, respektivisht të ndikon në rritjen e mirëqenies së qytetarëve Slloven.

### 3.3. Rekomandimet e OECD-së, për ndryshimin e normave tatimore në të ardhurat personale në Slloveni

Një rishikimi i sërishëm i tatimit mbi të ardhurat personale në Slloveni do të mundësonte uljen e kontributeve të sigurimeve shoqërore të punonjësve për pesë pikë përqindjeje - reformë kjo, që do të nxiste punësim më të lartë të punëtorëve që aktualisht nuk janë aktiv në tregun e punës - përfshirë punëtorët me të ardhura dhe kualifikime të ulëta, si dhe punëtorët e moshuar.

Për më tepër, për të ulur kontributet e sigurimeve shoqërore në Slloveni shkalla e tatimit mbi të ardhurat personale duhet të rrishkohet për të siguruar një buxhet të balancuar, edhe atë:

- së pari, grupi më i lartë i tatimit mbi të ardhurat personale mund të eliminohet (aktualisht konsiderohet si norma më e lartë e tatimit mbi të ardhurat personale, gjegjësisht 50% është shumë e lartë, e në veçanti në kombinim me kontributet e larta të sigurimeve shoqërore të punonjësve). Norma totale e kontributeve të sigurimeve shoqërore për punonjësit dhe shkalla më e lartë e tatimit mbi të ardhurat personale në Slloveni arrin në 61%, që është më e larta në mesin e vendeve të OECD-së. Shumë pak tatimpagues paguajnë normën më të lartë të tatimit mbi të ardhurat personale, andaj heqja e tatimit mbi të ardhurat më të larta (prej 50%), nuk do të ndikonte shumë në të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale.
- së dyti, normat tatimore për grupin e dytë, tretë dhe katërt tatimor (27%, 34% dhe 39%) mund të rriten për të ndihmuar financimin e uljes së kontributeve të sigurimeve shoqërore të punonjësve. Një rritje në normat e tatimit mbi të ardhurat personale do të varej nga shkalla e uljes së kontributeve të sigurimeve shoqërore të punonjësve. Norma më e ulët e tatimit mbi të ardhurat personale prej 16% mund të mbetet e pandryshuar për të maksimizuar ndikimin e uljes së kontributeve të sigurimeve shoqërore të punonjësve tek punëtorët me të ardhura të ulëta, kurse normat e tatimit mbi të ardhurat personale për klasën e tretë dhe të katërt mund të rriten më shumë se, normat e klasës së dytë. Megjithatë, norma e tatimit mbi të ardhurat personale për klasën e katërt (d.m.th. norma e re maksimale e tatimit mbi të ardhurat), nuk duhet të kaloj mbi 45%<sup>40</sup>.

Pra, në vendet e OECD-së, të ardhurat e gjeneruara nga tatimi personal në të ardhura mesatarisht arrijnë deri në 25% të të ardhurave totale tatimore, e në Slloveni deri në 14%, kurse të ardhurat e gjeneruara nga kontributet e sigurimeve shoqërore në vendet e OECD-së, mesatarisht arrijnë deri në 26% të të ardhurave totale tatimore, e në Slloveni pothuajse deri në 40%, prandaj kjo bazë duhet të zgjerohet.

---

<sup>40</sup> Për më shumë rreth rekomandimeve për ndryshime në sistemin tatimor Slloveni shërbehuni me: OECD, " *Summary and main findings of the OECD Study on Labor Tax Transformation in Slovenia* ", 2018. <https://www.oecd.org/ctp/tax-policy/povzet>

### **3.4. Analizë krahasimore e gjenerimit të të ardhurave nga tatimet direkte në Republikën e Maqedonisë së Veriut në raport me Republikën e Sllovenisë**

Shtetet e reja të Bashkimit Evropian në varësi të strukturës qeveritare dhe niveleve të zhvillimit ekonomik, kaluan nëpër reforma tatimore përpara se të anëtarësoheshin në Unioin Evropian. Meqenëse shumica prej tyre ishin pjesë e regjimeve të kaluara socialiste, këto të fundit ndanin karakteristikat e ekonomive në tranzicion - karakteristika këto, që përfshinin largimin nga një sistem tatimor të sheshtë dhe mungesën e kuadrit institucional. Maqedonia e Veriut duke hapur rrugën e saj drejtë një tatimi progresiv dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian, mësimet nga vendet që kanë pësuar në reforma tatimore mund të jenë mjaft të dobishme.


Për rrjedhojë, sjellim gjenerimin e të ardhurave të realizuara nga tatimi mbi të ardhurat personale dhe nga tatimi në fitim, në rastin e Republikës së Maqedonisë dhe Sllovenisë - vende këto, që janë të përafërta për nga numri i popullsisë, por me diskrepancë të madhe në gjenerimin e të ardhurave nga tatimet direkte (si rezultat i dallimit në sistemet tatimore).

#### **3.4.1. Analizë krahasimore e gjenerimit të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale në Republikën e Sllovenisë në raport me Republikën e Maqedonisë së Veriut.**

Republikën e Sllovenisë për dallim nga Republika e Maqedonisë së Veriut, zbaton normë progresive mbi të ardhurat personale duke filluar nga 16%, 27%, 34%, 39%, dhe 50%, kurse Maqedonia e Veriut normë të sheshtë 10%.

Në vijim, sjellim të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi të ardhurat personale si përqindje e PBB-së, në Republikën e Sllovenisë dhe Maqedonisë së Veriut.

***Grafikoni 1 - Të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi të ardhurat personale si përqindje e PBB-së, për Slloveninë dhe Maqedoninë e Veriut, për periudhën 2006-2020***



**Burimi: nga Ministrinë përkatëse të Financave për të dy vendet përkatëse.**


Nga grafikonin më sipër vërejmë se, përgjatë gjenerimit të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale si përqindje e PBB-së, Sllovenia si rezultat i aplikimit të progresivitetit gjeneron dyfish më shumë se Maqedonia e Veriut - progresivitet ky, që ka mundur një shpërndarje më të drejtë të të ardhurave, e njëherit ka zvogëluar hendekun mes të pasurve dhe të varfërve.

Për më tepër, në Slloveni të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi të ardhurat personale për periudhën 2006 - 2020, si përqindje e PBB-së, arrijnë mesatarisht në 5.4%, duke shënuar një minimum prej 5.1% për vitet 2013 - 2017, dhe një maksimum prej 5.8% për vitin 2008.

Nga ana tjetër, në Maqedoninë e Veriut të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi të ardhurat personale për periudhën 2006 - 2020, si përqindje e PBB-së, arrijnë mesatarisht në 2.3%, duke shënuar një minimum prej 2.0% për vite 2010 - 2013, dhe një maksimum prej 2.8% për vitin 2020.

Në vijim, në mënyrë kronologjike sjellim të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale si përqindje e totalit të të ardhurave të gjeneruara nga tatimet.

**Grafikoni 2 - Të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi të ardhurat personale si përqindje e totalit të të ardhurave të gjeneruara nga tatimet për Slloveninë dhe Maqedoninë e Veriut, për periudhën 2006-2020**



**Burimi: nga Ministrinë përkatëse të Financave për të dy vendet përkatëse.**

Nga grafikonin më lartë konstatohet se, të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale si përqindje e totalit të të ardhurave të gjeneruara nga tatimet mes Sllovenisë dhe Maqedonisë së Veriut kanë një diskrepancë të madhe si rezultat i aplikimit të normave të ndryshme tatimore.

Në Slloveni të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi të ardhurat personale për periudhën 2006 - 2020, si përqindje e totalit të të ardhurave të gjeneruara nga tatimet, arrijnë mesatarisht në 14.4%, duke shënuar një minimum prej 13.5% për vitin 2014, dhe një maksimum prej 15.3% për vitin 2008.

Ndërsa, në Maqedoninë e Veriut të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi të ardhurat personale për periudhën 2006 - 2020, si përqindje e totalit të të ardhurave të gjeneruara nga tatimet, arrijnë mesatarisht në 9.04%, duke shënuar një minimum prej 7.7% për vitin 2008, dhe një maksimum prej 10.2% për vitin 2018 (vërehet një trend rritës, ndonëse me një intenzitet të ulët).


Pra, si rezultat i aplikimit të normave të ndryshme tatimore mes Sllovenisë dhe Maqedonisë së Veriut, respektivisht progresivitetit pesë shkallësh në rastin e Sllovenisë, konstatohet se hendeku në kontekstin e gjenerimit të të ardhurave nga tatimi personal në shtetin në fjalë arrinë deri në 130% më shumë kundrejt vendit tonë - vend ky, i cili në Janar të vitit 2019, bëri një hap drejt aplikimit të progresivitetit dy shkallësh, mirëpo rezultoi si jo e suksesshme si reformë tatimore dhe zgjati vetëm një vit (si rezultat i presionit që shprehnin odat ekonomike në qeverinë e RMV-së).

### 3.4.2. Analizë krahasimore e gjenerimit të të ardhurave nga tatimi mbi fitim në Republikën e Sllovenisë në raport me Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Siç dihet, Republikën e Sllovenisë duke filluar nga 1 Janari i vitit 2013, zbaton normë tatimore të sheshtë prej 19% mbi tatimin në fitim dhe një normë të veçantë prej 0% në kushte të caktuara, posaçërisht për fondet e investimeve, pensione dhe për shoqëritë e sigurimit (planet e pensionit), kurse Republika e Maqedonisë së Veriut zbaton normë tatimore të sheshtë prej 10%.

Në vijim, sjellim të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi fitim si përqindje e PBB-së, në Republikën e Sllovenisë dhe atë të Maqedonisë së Veriut.

**Grafikoni 3 - Të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi fitim si përqindje e PBB-së, për Slloveninë dhe Maqedoninë e Veriut, për periudhën 2006-2020**




**Burimi: nga Ministrinë përkatëse të Financave për të dy vendet përkatëse.**

Nga grafikoni më sipër mund të vërejmë se, të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi fitim si përqindje PBB-së, mes Sllovenisë dhe Maqedonisë së Veriut nuk kanë një diskrepancë të madhe, respektivisht në Slloveni të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi fitim për periudhën 2006 - 2020, si përqindje e PBB-së, arrijnë mesatarisht në 1.8%, duke shënuar një minimum prej 1.2% gjatë periudhës 2012-2013, dhe një maksimum prej 3.2% për vitin 2007.

Ndërsa, në rastin e Republikës së Maqedonisë Veriut të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi fitim për periudhën 2006 - 2020, si përqindje e PBB-së, arrijnë mesatarisht në 1.4%, duke shënuar një minimum prej 0.8% gjatë periudhës 2010-2013, dhe një maksimum prej 2.2% për vitin 2018.

Për rrjedhojë, në mënyrë grafike sjellim edhe të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi fitim si përqindje e totalit të të ardhurave të gjeneruara nga tatimet.

**Grafikoni 4 - Të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi fitim si përqindje e totalit të të ardhurave të gjeneruara nga tatimet për Slloveninë dhe Maqedoninë e Veriut, për periudhën 2006-2020**



**Burimi: nga Ministrinë përkatëse të Financave për të dy vendet përkatëse.**

Nga grafikoni më sipër mund të vërejmë se, të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi fitim si përqindje e totalit të të ardhurave të gjeneruara nga gjithësej tatimet mes Sllovenisë dhe Maqedonisë së Veriut nuk kanë një diferencë të madhe, siç u vërejt në rastin e gjenerimit të të ardhurave nga tatimi personal në të ardhura, që do të thotë se ekziston një diskrepancë e vogël në rastin e tatimit në fjalë (Maqedonia e Veriut që nga viti 2015 gjeneron të ardhura më të larta nga tatimi në fitim si përqindje e totalit të të ardhurave të gjeneruara nga gjithësej tatimet, ndonëse kjo e fundit ka normë më të ulët se Sllovenia).

Për më tepër, në Slloveni të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi fitim për periudhën 2006 - 2020, si përqindje e totalit të të ardhurave të gjeneruara nga tatimet, arrijnë mesatarisht në 4.9%, duke shënuar një minimum prej 3.1% për vitin 2013, dhe një maksimum prej 8.3% për vitin 2007.

Ndërsa, në rastin e Republikës së Maqedonisë Veriut të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi fitim për periudhën 2006 - 2020, si përqindje e totalit të të ardhurave të gjeneruara nga tatimet, arrijnë mesatarisht në 5.5%, duke shënuar një minimum prej 3.2% për vitin 2012, dhe një maksimum prej 8.6% për vitin 2018.



Pra, sikurse Maqedonia e Veriut ashtu edhe Republika e Sllovenisë kanë strukturë të ngjajshme të të ardhurave të gjeneruara nga tatimet direkte, ndonëse kjo e fundit gjeneron të ardhura nga tatimet direkte disa herë më shumë - gjenerim ky, që na bën me dije se Sllovenia është një shtet dukshëm më i qëndrueshëm si në aspekt ekonomik ashtu edhe politik, andaj ndjekja e politikës tatimore si në rastin e Sllovenisë do i krijonte hapësirë vendit tonë për grumbullim të të ardhurave më të larta tatimore, duke siguruar në këtë mënyrë edhe efekte anësore, sikurse reduktim të pabarazisë në shoqëri dhe mirëqenie më të lartë.

## KAPITULLI IV: ANALIZË EMPIRIKE RRETH NEVOJËS DHE ARSYESHMËRISË PËR NJË SISTEM OPTIMAL TATIMOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

*"Pabarazia në të ardhura, dëmton ekonominë e një vendi" (Joseph Stiglitz).*

### 4.1. Shpërndarja e të ardhurave në Maqedoninë e Veriut

Vitet e fundit pabarazitë në shpërndarjen e të ardhurave janë shndërruar në një shqetësim global, ngase pothuajse 20%-shi, i të ardhurave globale është përqendruar në duart e 1%-shit, më fitimprurës. Pabarazitë në zhvillimin njerëzor janë akoma më të thella, edhe atë: p.sh një fëmijë i lindur në një mjedis me zhvillim të lartë njerëzor, në vitin 2000 kishte mundësi 50-të, me 50-të, për të marrë pjesë në arsimin e lartë, ndërsa një fëmijë i lindur në një mjedis me zhvillim të ulët njerëzor kishte vetëm 3 % mundësi. Për më tepër, çështja e pabarazisë në shpërndarjen e të ardhurave bëri jehonë të madhe, respektivisht u manifestua me protesta nga ana e lëvizjes Occupy, dhe morri një vëmendje të madhe në media dhe në qarqet e politike dhe kërkimore<sup>41</sup>.

Ekonomisti i njohur Paul Krugman, në vitin 2014 për gazetën New York Time konstatoi se, pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave pengon rritjen ekonomike. Në krahasim me mendimin liberal ekonomik, posaçërisht në 30-të vitet e fundit (1980-2010) se, tatimet e larta për të pasurit dhe rritja e ndihmave për të varfërit dëmton rritjen ekonomike, sot gjithnjë e më tepër përhapet një mendim ndryshe që sugjeron një rishpërndarje më të theksuar, respektivisht se tatimimi më i lart për të pasurit dhe ndihma për të varfërit mund ta intensifikoj dhe jo ta zvoglon normën e rritjes ekonomike. Kjo e fundit u përkrahë edhe nga Agjencioni reputativ „Standard and Poor’s”, jo vetëm bazuar në përmbledhjet e punimeve tjera në këtë sferë, por duke u bazuar edhe në punimet e veta. Për më tepër, edhe në studimet e fundit të FMN-së, rezulton se, ekziston një lidhje (korrelacion) i fuqishme midis rishpërndarjes së të ardhurave dhe normës më të lart dhe të qëndrueshme të rritjes ekonomike, e posaçërisht në vendet me shkallë zhvillimi mbi mesataren (rasti i SHBA-së tipik)<sup>42</sup>.

Për rrjedhojë, sa më shumë të ndahet një shoqëri në kontekst të pasurisë aq më ngurrues janë të pasurit që të shpenzojnë para për nevojat e përbashkëta, ngase të pasurit nuk kanë

<sup>41</sup> Për më shumë rreth pabarazisë në shpërndarjen e të ardhurave, shërbehuni me: M. Petreski, *"Beyond income inequality in North Macedonia"*, fq 5.

<sup>42</sup> Për më shumë rreth termit se pabarazia pengon rritjen ekonomike, shërbehuni me: A. Bexheti, *"Financa Publike"* fq. 68, 2017 Tetovë.

nevojë të mbështeten tek qeveria për parqe, arsim, kujdes mjekësor apo siguri personale. Një përqindëshi me të ardhura më të larta kanë shtëpitë, arsimimin, mjekët dhe stilin më të mirë të jetesës, por e harrojnë një gjë se paratë e tyre, respektivisht fati i tyre është i lidhur me mënyrën se si pjesa tjetër jeton (99 përqindëshi me të ardhura më të ulta)<sup>43</sup>. Se si duket shpërndarrja e të ardhurave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, shërbehuni me tabelën vijuese:

**Tabela 13: Shpërndarrja e të ardhurave në Maqedoninë e Veriut**

Grupi i të ardhurave	Pragu për grupin (denarë në vit)	Të ardhurat mesatare në grup (denarë në vit)
0%-50%	-	103.458
50%-60%	163.715	177.282
60%-70%	191.028	208.023
70%-80%	227.049	251.029
80%-90%	276.789	316.560
90%-95%	373.207	429.761
95%-96%	509.328	537.109
96%-97%	568.189	607.026
97%-98%	653.102	716.711
98%-99%	795.565	941.309
99%-100%	1.152.118	3.310.790

*Burim: Ministria e Finanave*

Nga të dhënat e prezantuara në tabelën më lartë mund të vërejmë se, nga gjithësej 3.4 miliard Euro të ardhura 1%-shi, i pjesës më fitimprurës ngërthen 470 milion Euro, ndërkohë që pjesa tjetër ngelet për 99 %-shin, e mbetur të popullsisë. Për më tepër, 50% - shi, i popullsisë disponojnë të ardhura mujore nën 212 Euro në muaj, 70%-shi, të ardhura mujore nën 297 Euro dhe 90%-shi, të ardhura mujore nën 495 Euro, kurse personat me të ardhura mbi 509,328 denar në vit, ose 690 Euro në muaj i përkasin 5%-shit, më fitimprurës. E nëse bëjmë krahasimin me ekstremimin e djathtë dhe të majtë mund të konstatojmë se, 20 të punësuar me të ardhura mesatare mujore prej 212 Euro, janë të barabartë me 1 person i punësuar me të ardhura mesatare mujore prej 4.486 Euro.

Për më tej, pasi që Republika e Maqedonisë së Veriut ka shkallë të lartë të pabarazisë në shpërndarrjen e të ardhurave, e njëkohësisht është vend akoma në zhvillim ku varfëria është e lartë, ndërhyrjet në sistemin tatimor janë të domosdoshme. Pabarazia në shpërndarrjen e të ardhurave, e lëre më pabarazitë në përgjithësi, janë çështje që akoma nuk janë pjesë intensive e diskurseve ekonomike, pavarësisht diskurseve globale në lidhje me këtë të fundit. Të dhënat e


<sup>43</sup> Për më shumë rreth pabarazisë në shpërndarrjen e të ardhurave, shërbehuni me: Joseph E. Stiglitz, "The Price of Inequality: How Today's Divided Society Endangers Our Future" <https://www.goodreads.com/work/quotes/19319742-the-price-of-inequality-how-today-s-divided-society-endangers-our-future>

para fiskale të publikuara në vitin 2017 për RMV-në, treguan se, 14%-shi, i të ardhurave ishte e përqendruar në duart e 1-shit, të fituesve më të mëdhenj duke reflektuar situatën globale të pabarazisë së të ardhurave.

Sipas të dhënave të fundit, pjesa e 1%-shit, më të pasur në të ardhurat totale është rritur në shumicën e vendeve të OECD-së, e në veçanti në tre dekadat e fundit. Sot, ato variojnë nga 7% në Danimarkë dhe Holandë, deri në pothuajse 20% në Shtetet e Bashkuara. Kjo rritje është si rezultat i 1%-shit, më të lartë që ka zënë një pjesë disproporcionale të rritjes së përgjithshme të të ardhurave gjatë tre dekadave të fundit, e që njëherit shpjegon se pse shumica e popullsisë nuk mund të barazojnë shifrat e rritjes së të ardhurave agregate, me ecurinë e të ardhurave të tyre. Në të njëjtën kohë, reformat tatimore në pothuajse të gjitha vendet e OECD-së, reduktuan normat më të larta tek tatimet direkte që përfshinin përfituesit më të mëdhenj. Për t'iu përgjigjur tendencave rritëse në lidhje me pabarazitë në shpërndarjen e të ardhurave, qeveritë kanë disa opsione në dispozicion, edhe atë: rritjen e tatimit efektiv të paguar nga përfituesit kryesorë të të ardhurave pa rritur domosdoshmërisht normat e tyre marginale, përmirësimin e pajtueshmërisë tatimore dhe reduktimin e shmangies së tatimeve.

Në vijim, paraqesim grafikonin e 1-shit, më fitimprurës në të ardhurat totale të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kundrejt disa vendeve më të zhvilluara.

**Grafikoni 5 - Pjesëmarrja e 1%-shit, më të pasur në të ardhurat e përgjithshme në vendet e zhvilluara dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut**



**Burimi: Ministria e Finacave**

Të dhënat e prezantuara në grafikonin më lartë tregojnë se, pjesëmarrja në të ardhurat e përgjithshme tek 1-shi, më fitimprurës i popullsisë në Maqedoninë e Veriut është 14.4 %, e që krahasimisht është shumë më e lartë kundrejt vendeve të OECD-së, si pjesëmarrës në këtë grafikon.

Pra, nga të dhënat e prezantuara në grafikonon vërejmë se, pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave në Maqedoninë e Veriut është në dukshëm e shprehur, andaj ndërhyrja në politikat tatimore të vendit është më se e nevojshme për të reduktuar pabarazinë në fjalë. Kjo e fundit, respektivisht diskrepanca e madhe në të ardhura mes klasave në shoqëri, është e ndërlidhur më tej me pabarazinë në sektorët tjerë, sikurse: arsim, shëndetësi, akses në tregun e punës, në ligj, etj.

## **4.2. Aplikimi i tatimit progresiv prej 18, 23, 25% dhe efektet në gjenerimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale në Maqedoninë e Veriut**

Sistemi tatimor i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka pësuar në reforma tatimore, respektivisht kalimin nga një një normë tatimore progresive në të ardhura personale, në një normë tatimore “flat”, apo e njohur ndryshe si e sheshtë. Për më tepër, deri në vitin 2006 sistemi tatimor i vendit tonë ishte progresiv, me tre nivele të normave tatimore edhe atë: 15%, 18% dhe 24 %. Në vitin 2007, ky i fundit u zëvendësua me një tatim të sheshtë prej 12 %, - normë kjo, e cila në vitin 2008 u ul në 10%, që vazhdon edhe sot e kësaj dite të aplikohet e njëjta normë (në fund të vitit 2018 u soll vendimi që në Janar të vitit 2019, të fillon aplikimi i normës tatimore progresive 10% dhe 18%, që u aplikua vetëm një vit).

Për rrjedhojë, Republika e Maqedonisë së Veriut nga tatimi personal në të ardhura gjeneron vetem 8 %, në raport me të ardhurat e përgjithshme tatimore, ose mesatarisht 2.3 %, në raport me PBB-në, e cila është shumë më e ulët se mesatarja prej 9.3% e vendeve të OECD-së. Gjenerimi i ulët i të ardhurave nga të ardhurat personale rezulton për shkak të mungesës së normave tatimore progresive mbi të ardhurat personale. Duke u nisur nga fakti se, Republika e Maqedonisë së Veriut pretendon që të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian, domosdoshmërisht duhet të mendoj për reforma në sistemin tatimor në atë mënyrë që t’i rrit normat tatimore mbi të ardhurat personale, respektivisht t’i rrit të ardhurat e gjeneruara nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Në vijim, sjellim skenarët e mundëshëm që Republika e Maqedonisë së Veriut mund t’i aplikoj, vetëm e vetëm t’i rrit të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale, si dhe të plotëson standardet ndërkombëtare, respektivisht duke optimalizuar sistemin tatimor të zvogëloj hendekun mes të pasurve dhe të varfërve në vend.

### **4.1.1. Skenari 1**

Një skenar i mundëshëm për të rritur të ardhurat nga tatimi personal në të ardhura në vendin tonë është ndryshimi i normës tatimore nga 10 %, në 18% për të ardhurat personale prej

700.000,00 denarë në vit, e që rrjedhimisht do të ndikoj edhe në zvoglimin e pabarazisë në shpërndarjen e të ardhurave në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në vijim do të paraqesim efektin e rritjes së normës tatimore nga 10%, në 18 % në gjenerimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale për personat që gjenerojnë të ardhura mbi 700.000,00 denarë në vit.

**Tabela 14: Rritja e normës tatimore nga 10%, në 18% për personat me të ardhura mbi 700.000,00 denarë në vit në RMV**

Numri i tatimpaguesve	Mes atarja e të ardhurave	Shuma	Aplikimi i tatimit të sheshtë prej 10%	Tatimi 10%+18% progresiv	Diferenca
9.408	716.711	6.742.817.088	674.281.708	686.859.075	12.557.367
9.408	941.309	8.855.835.072	885.583.507	1.067.202.312	181.618.805
9.408	3.310.790	31.147.912.320	3.114.791.232	5.079.776.217	1.964.984.985
<b>Totali</b>					<b>2.159.161.157</b>

Në tabelën më lartë kemi llogaritur tatimpaguesit që do t'i tangon aplikimi i normës tatimore progresive, e që njëherit janë 3% i më të pasurve nga totali i tatimpaguesve (llogaritur me numrin total të personave që përfitojnë të ardhura, personat që tejkalojnë pragun prej 700.000,00 denarë në vit janë 28.224 tatimpagues). Ndryshimi i normës tatimore nga e sheshta në progresive, respektivisht nga 10 %, në 18 %, do të rezulton me rritjen e të ardhurave nga tatimi personal me 2.159.161.157 denarë, ose për 11 %.

Pra, me aplikimin e tatimit progresiv, të ardhurat nga tatimi personal do të marrin pjesë në totalin e të ardhurave tatimore me 11.5% , që aktualisht marrin pjesë me një mesatare prej 9 %, kurse të ardhurat tatimore nga tatimi personal në të ardhura në raport me PBB-në, do të rriten nga mesatarja që aktualisht është 2.3%, në 3 %.

#### 4.1.2. Skenari 2

Një skenar tjetër i mundëshëm për të rritur të ardhurat nga tatimi personal në të ardhura në vend është ndryshimi i normës tatimore nga 10%, në 23%, e që për dallim nga skenari i parë përpos normës tatimore kemi rritur edhe pragun nga 700.000,00, në 900.000,00 denarë.

Në vijim do të paraqesim efektin e rritjes së normës tatimore nga 10 %, në 23 % në gjenerimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale për personat që gjenerojnë të ardhura mbi 900.000,00 denarë në vit.

**Tabela 15: Rritja e normës tatimore nga 10%, në 23 % për personat me të ardhura mbi 900.000,00 denarë në vit, në Maqedoninë e Veriut**

Numri i tatimpaguesve	Mes atarja e të ardhurave	Shuma	Aplikimi i tatimit të sheshtë prej 10%	Tatimi 10%+23% progresiv	Diferenca
9.408	941. 309	8.855.835.0 72	885.583.507	936.106.066	50.522.5 9
9.408	3.31 0.790	31.147.912. 320	3.144.791.232	6.063.283.8 33	2.918.49 106
<b>Totali</b>					<b>2.969.015.160</b> 160

Në tabelën më lartë kemi llogaritur tatimpaguesit që do t'i tangon aplikimi i normës tatimore progresive, e që njëherit janë 2 % i përfituesve më të pasur (llogaritur me numrin total të personave që tejkalojnë pragun prej 900.000,00 denarë në vit janë 18.816 tatimpagues). Ndryshimi i normës tatimore nga e sheshtë në progresive, respektivisht nga 10 %, në 23 %, do të rezultojnë me rritjen e të ardhurave nga tatimi personal për 2.969.015.160 denarë, ose rreth 16%.

Pra, me aplikimin e tatimit progresiv, të ardhurat nga tatimi personal do të marrin pjesë në totalin e të ardhurave tatimore me 12,5 %, që aktualisht merr pjesë me një mesatare prej 9 %, kurse të ardhurat tatimore nga tatimi personal në të ardhura në raport me PBB-në, do të rriten nga mesatarja që aktualisht është 2.3%, në 3.2% - rritja e normës tatimore në një prag më të lartë, në njërin anë rrit gjenerimin e të ardhurave tatimore, kurse në anën tjetër rrit edhe ngarkesën tatimore për të pasurit.

#### 4.1.3. Skenari 3

Një skenar tjetër i mundëshëm për të rritur të ardhurat nga tatimi personal në të ardhura në vendin tonë është ndryshimi i normës tatimore nga 10 %, në 25 % për të ardhurat personale prej 900.000,00 denar në vit - ndryshim ky, që do të ndikon në zvoglimin e hendekut mes të

pasurve dhe të varfërve në Maqedoninë e Veriut (për dallim nga skenari dytë, në skenarin e tretë kemi rritur normën tatimore pa mos e ndryshuar pragun tatimor).

Në vijim sjellim efektin e rritjes së normës tatimore nga 10 % në 25 % në gjenerimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale, për personat që gjenerojnë të ardhura mbi 900.000 denarë në vit.

**Tabela 16: Rritja e normës tatimore nga 10% në 25 % për personat me të ardhura mbi 900.000,00 denar në vit në Maqedoninë e Veriut**

Numri i tatimpaguesve	Mesatarja e të ardhurave	Shuma	Aplikimi i tatimit të sheshtë prej 10%	Tatimi 10%+25% progresiv	Diferenca
9.408	941.30	8.855.835.	885.583.507	943.878.76	58.295.26
	9	072		8	1
9.408	3.310.	31.147.912	3.114.791.2	6.516.898.	3.402.106
	790	.320	32	080	.848
<b>Totali</b>					<b>3.460.402</b>
					<b>.109</b>

Në skenarin e tretë kemi llogaritur tatimpaguesit që do t'i tangon aplikimi i normës tatimore progresive, e që njëherit janë 2 %-shi më i pasur (llogaritur me numrin total të përfituesve personat që tejkalojnë pragun prej 900.000,00 denarë në vit janë 18.816 tatimpagues). Ndryshimi i normës tatimore nga e sheshtë në progresive, respektivisht nga 10 %, në 25 %, do të rezultojnë me rritjen e të ardhurave nga tatimi personal për 3.460.402.109 denarë, ose rreth 20%.

Pra, me aplikimin e tatimit progresiv, të ardhurat nga tatimi personal do të marrin pjesë në totalin e të ardhurave tatimore me 13 %, që aktualisht merr pjesë me një mesatare prej 9 %, kurse të ardhurat tatimore nga tatimi personal në të ardhura në raport me PBB-në, do të rriten nga mesatarja që aktualisht është 2.3%, në 3.3% (për dallim nga skenari i parë dhe i dytë një normë më e lartë tatimore për të pasurit dhe në një prag më të lartë, rrit ndjeshëm gjenerimin e të ardhurave, rrjedhimisht edhe barën tatimore për të pasurit).

#### 4.1.4. Skenari 4

Duke marr parasysh se skenarët më sipër pasqyrojnë një optimizëm shumë të lartë nga ana ynë, e realisht janë shumë larg mundësisë për implementim dhe politikës aktuale tatimore (përvoja e vitit 2019 e dëshmoi të njëjtën), në vijim sjellim skenarin që është shumë afër mundësisë për realizim, ngase merr për bazë pragun prej 120.000,00 Den ne muaj ose 1.440.000 den në vit, dhe normën tatimore prej 15%, e që njëherit do e tangoj vetem 1%-shin e popullsisë së Maqedonisë së Veriut (arritje me e lartë e drejtshmërisë vertikale).



**Tabela 16: Rritja e normës tatimore nga 10% në 15% për personat me të ardhura mbi 1,440,000 denarë në vit në RMV**

Numri i tatimpaguesve	Mesat arja e të ardhurave	Shuma	Tatimi 10% i sheshtë	Tatimi 10%+15% progresiv	ca	Diferen
9.408	3.310. 790	31.147.91 2.320	3.114.791.2 32	3.994.810.8 48	616	880.019.
<b>Totali</b>					<b>616</b>	<b>880.019.</b>

Në skenarin e katërt kemi llogaritur tatimpaguesit që do t'i tangon aplikimi i normës tatimore progresive, e që njëherit janë 1 % i përfituesve më të pasur (llogaritur me numrin total të përfituesve, personat që tejkalojnë pragun prej 1.440.000 denarë në vit janë 9.408 tatimpagues). Ndryshimi i normës tatimore nga e sheshtë në progresive, respektivisht nga 10 %, në 15 %, do të rezultojn me rritjen e të ardhurave nga tatimi personal për 880.019.616 denarë, ose rreth 5%.

Pra, me aplikimin e tatimit progresiv, të ardhurat nga tatimi personal do të marrin pjesë në totalin e të ardhurave tatimore me 10 %, që aktualisht merr pjesë me një mesatare prej 9 %, kurse të ardhurat tatimore nga tatimi personal në të ardhura në raport me PBB-në, do të rriten nga mesatarja që aktualisht është 2.3%, në 2.9%.

Së fundmi, nga skenarët e llogaritur më lartë mund të konkludojm se, një normë më e lartë e tatimit personal në të ardhura mbi një prag më të lartë (aplikimi i normës progresive në të ardhurat personale), në njërin anë rrit ndjeshëm të ardhurat nga tatimi progresiv, kurse në anën tjetër ul pabarazinë në vend, andaj qeveria këto mjete të mledhura duhet t'i destinoj në luftën kundër varfërisë dhe rritjen e mirëqenies së popullsisë (zvogëlimin e hendekut mes të pasurve dhe të varfërve).

## 4.2. Testimi i hipotezave

Përgjatë llogaritjes së skenarve më lartë konstatuam se, rritja e normes tatimore mbi tatimin personal në të ardhura rrit dukshëm të ardhurat e përgjithshme tatimore. Duke marrë për bazë këtë të fundit, mund të themi se Republika e Maqedonisë së Veriut ka hapsirë për reforma tatimore që do shpjen më tej në reduktim të pabarazisë gjatë shpërndarjes së të ardhurave publike.

Në vijim, sjellim testimin e hipotezës kryesore dhe tyre ndihmëse të ngritura në fillim të studimit, sikurse:

Testimi i hipotezës kryesore	Pranojmë ose hedhim poshtë (për testimin e hipotezës kryesore shërbehemi me rezultatet nga llogaritja e skenarëve për përfshirje më të gjërë të detyruesve tatimor)
<p><b>1. Përfshirja më e gjërë e detyruesve tatimor (bazës tatimore), kontribuon në gjenerimin e të ardhurave publike më të larta, rrjedhimisht ul hendekun mes të pasurve dhe të varfërve.</b></p>	<p>Gjatë llogaritjes së skenarve të mundshëm për një sitem më optimal konstatuam se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ rritja e normës tatimore nga 10% në 18%, për personat me të ardhura mbi 700.000,00 denarë në vit, do t'i rrit të ardhurat për 2.159.161.157 denarë, ose për 11 %;</li> <li>▪ rritja e normës tatimore nga 10% në 23 % për personat me të ardhura mbi 900.000,00 denarë në vit, do t'i rrit të ardhurat për 2.969.015.160 denarë, ose për rreth 16%;</li> <li>▪ rritja e normës tatimore nga 10%, në 25%, për personat me të ardhura mbi 900.000,00 denarë në vit, do t'i rrit të ardhurat për 3.460.402.109 denarë, ose rreth 20%.</li> </ul> <p>Pra, duke marrë për bazë llogaritjen e skenarëve për të gjeneruar të ardhura më të larta tatimore, konstatojmë se: <b>përfshirja më e gjërë e detyruesve tatimor (bazës tatimore), kontribuon në gjenerimin e të ardhurave publike më të larta, rrjedhimisht ul hendekun mes të pasurve dhe të varfërve, e rrjedhimisht hipoteza kryesore pranohet.</b></p>

Për mbështetjen e hipotezës kryesore kemi ngritur edhe hipotezat ndihmëse, sikurse në vijimi:

Testimi i hipotezave ndihmëse	Pranojmë ose hedhim poshtë (për testimin e hipotezave ndihmëse shërbehemi me gjetjet nga studimet paraprake (rrethikimin e literaturës), rezultatet nga të dhënat statistikore, krahasimin me vendet e BE-së, dhe BP-së)
<p>1. Si rezultat i nevojave, arsyeshmërisë dhe elasticitetit, Republika e Maqedonisë së Veriut ka hapsirë për ngritje/ulje të tatimeve, respektivisht për një sistem optimal tatimor.</p>	<p>Gjatë ekzaminimit të të dhënave statistikore për drejtshmërinë në shpërndarjen e të ardhurave konstatuam se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ 50 % përfitojnë të ardhura me një mesatare prej 103.458,00 denarë në vit, kurse 1 % më fitimprurës përfiton të ardhura me një mesatare prej 3.310.790,00 denarë në vit;</li> <li>▪ normat tatimore janë shumë më të ulta se mesatarja e Bashkimit Evropian, si dhe mesatarja e vendeve të Ballkanit Perendimor;</li> <li>▪ gjenerimi i të ardhurave nga tatimet në Maqedoninë e Veriut janë për 62 % më të ulta, në krahasim me mesataren e Bashkimit Evropian;</li> <li>▪ pjesëmarrja në të ardhurat e përgjithshme të 1%-shi, më fitimprurës të popullsisë në Maqedoni është 14.4%.</li> <li>▪ Në krahasim me vendet me pabarazi të vogël të të ardhurave (vendet e OECD-së), pjesëmarrja e pjesës më fitimprurëse prej 1%, në mënyrë të konsiderueshme është më e vogël, krahasuar me atë në Maqedoni.</li> </ul> <p>Duke marrë për bazë ekzaminimin e mësipër, konstatojmë se: <b>si rezultat i nevojave, arsyeshmërisë dhe elasticitetit, Republika e Maqedonisë së Veriut ka hapsirë për ngritje/ulje të tatimeve, respektivisht për një sistem optimal tatimor, rrjedhimisht hipoteza e parë ndihmëse pranohet.</b></p>

2. *Ndryshimi i normës tatimore tek tatimet direkte, rrjedhimisht rritja e bazës tatimore do të ndikoj në rritjen e të ardhurave publike nga tatimet dhe në uljen e varfërisë.*

Gjatë llogaritjes së skenarëve për një sistem më optimal tatimor me norma më të larta tatimore te tatimet direkte, konstatuam se:

- ndryshimi i normës tatimore nga e sheshta në progresive, respektivisht nga 10%, në 18 %, do të rezultoj me rritjen e të ardhurave nga tatimi personal në të ardhura, e njëkohësisht me aplikimin e tatimit progresiv të ardhurat personale do të marrin pjesë në totalin e të ardhurave tatimore me 11.5 %, që aktualisht marrin pjesë me një mesatare prej 9%, kurse në raport me PBB-në do të rriten nga mesatarja aktuale prej 2.3%, në 3.0%;
- ndryshimi i normës tatimore nga e sheshta në progresive, respektivisht nga 10%, në 23 %, do të rezultoj me rritjen e të ardhurave nga tatimi personal në të ardhura, e njëkohësisht me aplikimin e tatimit progresiv të ardhurat personale do të marrin pjesë në totalin e të ardhurave tatimore me 12.5%, e që aktualisht marrin pjesë me një mesatare prej 9%, kurse të ardhurat personale në raport me PBB-në, do të rriten nga mesatarja aktuale prej 2.3%, në 3.2 %;
- ndryshimi i normës tatimore nga e sheshta në progresive, respektivisht nga 10 %, në 25 %, do të rezultoj me rritjen e të ardhurave nga tatimi personal në të ardhura, e njëkohësisht, me aplikimin e tatimit progresiv të ardhurat personale do të marrin pjesë në totalin e të ardhurave tatimore me 13 %, e që aktualisht marrin pjesë me një mesatare prej 9 %, kurse të ardhurat personale në raport me PBB-në, do të rriten nga mesatarja aktuale prej 2.3%, në 3.3 %.

Gjatë gjenerimit të skenarëve potencial për rritjen e të ardhurave nga tatimi personal në të ardhura, konstatuam se: ***normat tatimore më të larta tek të pasurit do të gjenerojnë të ardhura më të larta tatimore (drejtmëri vertikale) - të ardhura këto, që do të rishpërndahen më tej në luftën kundër varfërisë, rrjedhimisht do të kontribuojnë në uljen e varfërisë dhe rritjen e mirëqenies së popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Andaj, hipoteza: dryshimi i normës tatimore tek tatimet direkte, rrjedhimisht rritja e bazës tatimore do të ndikoj në rritjen e të ardhurave publike nga tatimet dhe në uljen e varfërisë është e pranueshme.***

3. Republika e Maqedonisë së Veriut ka hapësirë që ta rrit normën e tatimit në fitim për 3 % - normë kjo, e cila do t'i mundëson vendit të gjeneroj të ardhura publike më të larta, e njëherit të mbetet një destinacion konkurrues për investimet e huaja.

Gjatë shqyrtimit të literaturës dhe gjetjeve në drejtim të analizës për elasticitetin e normës tatimore mbi tatimin në fitim, konstatuam se:

- rritja e normës tatimore mbi tatimin në fitim nga 10%, në 13%, do të gjeneroj të ardhura më të larta në vend, e po ashtu do të mbetet brenda kornizave të normave tatimore në Ballkanin Perendimor (9-15%);
- rritja e normës tatimore mbi tatimin në fitim duke qëndruar brenda kornizave të Ballkanit Perendimor do të rrit të ardhurat për 0.4%, si përqindje e PBB-së;
- rritja e normës mbi tatimin në fitim do të mbetet e krahasueshme dhe konkurruese në raport me normën e vendosur të shteteve të Ballkanit Perendimor, e nuk do të ndikojë në uljen e investimeve të huaja në Maqedoninë e Veriut.

Gjatë ekzaminimit të literaturës për rritjen e normes tatimore mbi tatimin në fitim konstatojm se: ***rritja e normës tatimore mbi tatimin në fitim duke qëndruar brenda kornizave të shteteve Ballkanike do të rrit të ardhurat nga tatimi në fitim dhe nuk do të ndikojë në uljen e investimeve të huaja në Maqedoni, dhe rrjedhimisht hipoteza ndihmëse është e pranueshme.***

Pra, gjatë testimit të hipotezës kryesore dhe atyre ndihmëse të ngritura në fillim të studimit, bazuar në arsyeshmërinë dhe nevojën për një sistem më optimal tatimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sërish konstatojmë se Maqedonia e Veriut ka hapësirë për rritjen e normës tatimore mbi të ardhurat personale, respektivisht kalimi nga tatimi i sheshtë në atë progresiv është më se i nevojshëm dhe i arsyeshëm për të zvogëluar hendekun mes të pasurve dhe të varfërve, rrjedhimisht të rrit mirëqenien në vend.

## KAPITULLI V: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

### **Konkluzionet që dalin nga ky studim do t'i sistemoj si në vijim:**

1. Vendet me një zhvillim të mëvonshëm, apo siç njihen ndryshe vendet në tranzicion kanë pësuar në reforma tatimore si rezultat i nevojës për të gjeneruar të ardhura tatimore sa më të larta, për të rritur shpenzimet publike, e rrjedhimisht të rritin edhe më shumë mirëqenien e qytetarëve në vend.

2. Sistemet tatimore të vendeve të zhvilluara, krahasuar me sistemet e vendeve në tranzicion janë më të përsosura (me më pak difekte), me mundësi më të ulët për evazion fiskal, me mirëqenie shumë të lartë - karakteristika këto, që kanë bërë që qytetarët e vendeve të zhvilluara shumë më lehtë t'i pranojnë reformat tatimore, kundrejt atyre të vendeve në tranzicion.

3. Duke ndjekur reformat tatimore të ndërmarra në vendet në tranzicion (vende me vullnet politik) mund të themi se, impenjimi dhe zbatimimi i reformave tatimore brenda vendit tonë synoi përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe mirëqenien shoqërore, rritjen e standardit jetësor, menjanimin e evazionit fiskal, etj.

4. Duke i ndjekur asokohe sistemet tatimore ekzistuese të vendeve të zhvilluara, njëherit për të plotësuar kërkesat e Bashkimit Evropian për një sistemin tatimor më optimal (gjë që ishte parakusht për antarësim), në vitin 1994 në Republikën e Maqedonisë së Veriut u ndërmorën reforma tatimore me qëllim të thjeshtësimit të sistemit tatimor dhe rritjes së efikasitetit. Koncepti për një sistem të ri tatimor propozonte një strukturë tatimore më efikase - rregullimin e llojeve të tatimeve.

5. Arritja e optimalitetit të sistemit tatimor të RMV-së, nvaret nga vendimet e qeverisë dhe objektivat e saj politike. Aplikimi i një normë më të lartë tatimore mbi tatimet direkte do të gjeneroj të ardhura tatimore më të larta, do të siguroj progresivitet dhe arritje të drejtshmerisë vertikale në tatimim.

6. Republika e Maqedonisë së Veriut ka norma tatimore më të ulta se të gjithë vendet e Bashkimit Evropian. Për rrjedhojë, gjeneron të ardhura shumëfish më të ulta (larg direktivës së BE-së), andaj për t'u bërë pjesë e Unionit Evropian, Maqedonisë së Veriut i duhet të mendoj për reforma tatimore që të jetë në harmonizim me direktivën e BE-së.

7. Gjatë krahasimit të Sllovenisë me Maqedoninë e Veriut në drejtim të gjenerimit të të ardhurave tatimore përgjatë periudhës 2006 - 2007 mund të konkludojmë se, Sllovenia gjeneron të ardhura nga tatimet direkte disa herë më shumë se Maqedonia e Veriut, gjë që nxjerr në përfundimin se, Sllovenia është një vend dukshëm më i zhvilluar ekonomikisht dhe më i qëndrueshëm politikisht.

8. Për periudhën e analizuar, respektivisht 2006 - 2020, Sllovenia nga tatimi personale ka gjeneruar 130% të ardhura më të larta sesa Maqedonia e Veriut. Disklepanca e madhe në gjenerimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale në mes Sllovenis dhe Maqedonisë, është si rezultat i aplikimit të normave tatimore të ndryshme që kanë këto dy vende.

9. Në Maqedoninë e Veriut ekziston një hendek i madh në shpërndarjen e të ardhurave, ku 1%-shi, më fitimprurës ngërthen 470 milion Euro nga gjithësej 3.4 miliard, kurse pjesa tjetër mbetet për 99%. Te vendet me pabarazi të vogël (vendet e OECD-së), pjesëmarrja e pjesës më fitimprurëse prej 1 %, është dukshëm më e vogël në krahasim me atë të Maqedonisë së Veriut.

10. Gjatë gjenerimit të skenarit të parë konstatuam se, me rritjen e normës tatimore nga 10%, në 18%, me një prag prej 700.000,00 denarë, shkakton rritjen e të ardhurave tatimore për 2.159.161.157 denarë, ose për 11%.

11. Gjatë gjenerimit të skenarit të dytë konstatuam se, me rritjen e normës tatimore nga 10%, në 23%, me një prag prej 900.000,00 denarë, shkakton rritjen e të ardhurave tatimore për 2.969.015.160 denarë, ose për 16%.

12. Gjatë gjenerimit të skenarit të tretë konstatuam se, me rritjen e normës tatimore nga 10%, në 25%, me një prag prej 900.000,00 denarë, shkakton rritjen e të ardhurave tatimore për 3.460.402.109 denarë, ose për 20%.

13. Nga përlogaritja e skenarëve mund të konkludojmë se, aplikimi i normës progresive tek tatimi mbi të ardhurat personale (mbi një prag të lartë), në njërin anë rrit ndjeshëm të ardhurat tatimore, kurse në anën tjetër ndikon në uljen e pabarazisë dhe rrijten e mirëqenies shoqërore.

## **Rekomandimet kryesore që rezultojnë nga ky studim janë:**

**1. Përqëndrimi në përpilimin e një programi për reforma të rrënjësishme në sistemin tatimor.** Vendet që gjenerojnë të ardhura të ulta tatimore (sikurse Maqedonia e Veriut), nëse do të ndjekin sistemet tatimore të vendeve të zhvilluara, të cilat gëzojnë gati dyfishin e të ardhurave nga tatimet (në krahasim me vendet në tranzicion), duhet patjetër të zbatojnë një nivel më të lartë të normave tatimore. Pra, Maqedonia e Veriut që përpiqet të integrohet plotësisht në ekonominë botërore, duhet së pari të arrijë në një optimalitet të sistemit tatimor dhe i cili do të jetë më i përafërt me vendet e Bashkimit Evropian.

**2. Zbatimi i rekomandimeve të Bashkimit Evropian për një sistem më optimal tatimor.** Reformat tatimore në Maqedoninë e Veriut janë të nevojshme dhe të domosdoshme (për t'u harmonizuar me direktivën e BE-së), respektivisht rritja e normave tatimore do të ndikojë në rritjen e të ardhurave nga tatimi, e njëherit do të inkadrojë edhe progresivitet më të madh në sistemin tatimor të Maqedonisë së Veriut.

**3. Rritja e normës tatimore në tatimin mbi fitim dhe tatimin mbi të ardhurat personale.** Problemi kryesor në gjenerimin e ulët të të ardhurave nga tatimet direkte qëndron pikërisht nga aplikimi i normës së sheshtë tatimore prej 10%. Me zëvendësimin e normës së sheshtë tatimore me një normë progresive, Maqedonia e Veriut do të ketë rritje në pjesëmarrjen e të ardhurave tatimore nga tatimet direkte, ashtu siç ndodh në shtetet Evropiane, përfshirë edhe Sloveninë.

**4. Ndërmarrja e masave për zvoglimin e pabarazisë në Maqedoninë e Veriut.** Pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave është në shkallë të lartë, andaj ndërhyrja në politikat tatimore të vendit është më se e nevojshme për të reduktuar pabarazinë. Për më tepër, diferenca e madhe në të ardhura mes të pasurve dhe të varfërve është e ndërlidhur me pabarazinë në arsim, shëndetësi, akses në tregun e punës, në ligji, etj. E pra, kur këto të fundit rriten, rritet edhe pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave.

**5. Zëvendësimi i normës së sheshtë me atë progresive tek tatimit mbi të ardhurat personale** Maqedonia e Veriut ka hapsirë për të rritur normën e tatimit mbi të ardhurat personale, e që aktualisht tatimpaguesit taten me 10%. Zbatimi i një norme progresive ( 18%, 23% , 25%), mbi një prag më të lartë, në njërin anë do t'i rrit të ardhurat nga tatimi direkt, do të përmirësojë bilancin buxhetor, do të sigurojë drejtshmëri vertikale në tatimim, e në anën tjetër do të ndikojë në zvoglimin e varfërisë në vend, rrjedhimisht në rritjen e mirëqenies shoqërore.



## Bibliografia:

1. A.Bexheti "Financa Publike" Tetovë 2017, fq.97
2. B.J.Jante, " Income Tax " April 2021
3. K.Julia "Corporate Tax " Februar 2021 <https://www.investopedia.com/terms/c/corporatetax.asp>
4. Fondacioni Fridrih Ebert "Eja te flasim për tatimet" <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/skopje/15604.pdf>
5. "Publication 510, Excise Tax (Including Fuel Tax Credits and Refunds," Page 2. Accessed Jan. 19, 2020.
6. : IBDP Publikations" Tax policy in OECD Countries", Amsterdam,1993, str.52
7. " The Reform of Taxation in EU Member States", nga Centre d'tudes et d'Information Internationales (CEPII) Paris, page 88, May 2001, [https://www.europarl.europa.eu/workingpapers/econ/pdf/127\\_en.pdf](https://www.europarl.europa.eu/workingpapers/econ/pdf/127_en.pdf)
8. " The Reform of Taxation in EU Member States", nga Centre d'tudes et d'Information Internationales (CEPII) Paris, page 87, May 2001, [https://www.europarl.europa.eu/workingpapers/econ/pdf/127\\_en.pdf](https://www.europarl.europa.eu/workingpapers/econ/pdf/127_en.pdf)
9. " The Reform of Taxation in EU Member States", nga Centre d'tudes et d'Information Internationales (CEPII) Paris, page 90, May 2001, [https://www.europarl.europa.eu/workingpapers/econ/pdf/127\\_en.pdf](https://www.europarl.europa.eu/workingpapers/econ/pdf/127_en.pdf)
10. Cf. S. Acharya "The Indian Economy. Recent Development and Future Prospects", Boulder, London 1988
11. Cf. World Bank: World Development Report 1988, Washington, D.C., 1988.
12. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, "Historiku I Tatimeve" <https://www.financa.gov.al/historiku-i-tatimeve/>
13. B.Peci, "Reformat tatimore në shtetet ballkanike – rasti i Kosovës" 2009, fq 55
14. Taxation in Montenegro, "Tax System" <https://montenegrotaxation.com>
15. Ministry of Finance, "Tax System" <https://www.minfin.bg/en/6>
16. J.K.Shirazi dhe A.Shah, "Tax Reform in Developing Countries" (What constitutes successful tax reform? A review of developing country experience), June 1991
17. Atanasovski, Zhivko: Financa publike, Fakulteti Ekonomik, Shkup, fq 537
18. Atanasovski, Zhivko: Financa publike, Fakulteti Ekonomik, Shkup, fq 537
19. P.Dejan Nauka o porezima I poresko pravo,Savremena administracija, Beograd, 1997.
20. OECD, "Policy framework for investment users toolkit", Kapitulli 5, fq 2
21. Ministria e Financave, "Tatimi personal mbi të ardhura",2021 <https://finance.gov.mk>
22. Ministria e Financave, "Tatimi mbi fitim",2021 <https://finance.gov.mk>
23. Gazeta Zyrtare e RM 44/99, ... 275/19, "Ligji për tatimin mbi vlerën e shtuar"
24. Ministria e Financave, "Tatimi në pasuri",2021 <https://finance.gov.mk>
25. Ministria e Financave, "Kontributet",2021 <https://finance.gov.mk>
26. International Bank for Reconstruction and Development / The World Bank, " Rishikimi i financave publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut", Washington DC, 2018, faqe 66.
27. Banka Botrore, "Rishikimi i Financave Publike", 2019, fq 76
28. Banka Botrore, "Rishikimi i Financave Publike", 2019, fq 77

29. Banka Botërore , "Vështrim i përgjithshëm i financave publike në Maqedoni", 2018
30. Institute of Public Finance, Zagreb, Smičiklasova 21 "Reformat tatimore, eksperiencia dhe prespektiva" 2014, fq 150 [http://www.ijf.hr/upload/files/file/knjiige/tax\\_reform\\_proceedings.pdf](http://www.ijf.hr/upload/files/file/knjiige/tax_reform_proceedings.pdf)
31. Institute of Public Finance, Zagreb, Smičiklasova 21 "Reformat tatimore, eksperiencia dhe prespektiva" 2014, fq 152 [http://www.ijf.hr/upload/files/file/knjiige/tax\\_reform\\_proceedings.pdf](http://www.ijf.hr/upload/files/file/knjiige/tax_reform_proceedings.pdf)
32. OECD, "Reformat e politikës ekonomike në Sloveni 2021" <https://www.oecd-ilibrary.org/sites/e943aab0-en/index.html?itemId=/content/component/e943aab0-en>
33. : Ministry of Finance Slovenia, "Taxation in Sloveni", <https://www.gov.si/en/state-authorities/ministries/ministry-of-finance/>
34. Ministria Financës, "Taxation in Sloveni", Februar 2018, fq 9, [https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation\\_in\\_Slovenia\\_2018.pdf](https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation_in_Slovenia_2018.pdf)
35. : Ministria Financës, "Taxation in Sloveni", Februar 2018, fq 14, [https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation\\_in\\_Slovenia\\_2018.pdf](https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation_in_Slovenia_2018.pdf)
36. : Ministria Financës, "Taxation in Sloveni", Februar 2018, fq 23, [https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation\\_in\\_Slovenia\\_2018.pdf](https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation_in_Slovenia_2018.pdf)
37. Ministria Financës, "Taxation in Sloveni", Februar 2018, fq 25, [https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation\\_in\\_Slovenia\\_2018.pdf](https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation_in_Slovenia_2018.pdf)
38. Ministria Financës, "Taxation in Sloveni", Februar 2018, fq 26, [https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation\\_in\\_Slovenia\\_2018.pdf](https://www.gov.si/assets/ministrstva/MF/Davcni-direktorat/DOKUMENTI/Taxation_in_Slovenia_2018.pdf)
39. OECD, "Përmbledhje dhe gjetjet kryesore të Studimit të OECD-së mbi Transformimin e Tatimit të Punës në Slloveni", 2018 <https://www.oecd.org/ctp/tax-policy/povzet>
40. Marjan Petreski, "Beyond income inequality in North Macedonia", fq 5.
41. A.Bexheti, "Financa Publike" fq 68, 2017 Tetovë.
42. Joseph E. Stiglitz, "The Price of Inequality: How Today's Divided Society Endangers Our Future" <https://www.goodreads.com/work/quotes/19319742-the-price-of-inequality-how-today-s-divided-society-endangers-our-futur>

